# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2024 – Numri: 97

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare


**Tiranë – E hënë, 10 qershor 2024**

## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 52/2024, datë 16.5.2024 | Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji................................ | 10571 |
| Dekret i Presidentit nr. 225, datë 5.6.2024 | Për shpallje ligji........................................................................................ | 10579 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 337, datë 5.6.2024 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar.......................................................................... | 10580 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 5.6.2024 | Për disa shtesa në vendimin nr. 167, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë, Kamzë dhe Rrogozhinë", të ndryshuar............................................................... | 10581 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 339, datë 5.6.2024 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 240, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare 'Bago', Bashkia Kavajë, dhe caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese".................... | 10581 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 340, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar", të ndryshuar...................... | 10582 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 341, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 27, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë dhe Kurbin", të ndryshuar......................................................................... | 10582 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 342, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 359, datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë dhe caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese", të ndryshuar | 10583 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 180, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit në Bashkinë Krujë", të ndryshuar | 10583 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 344, datë 5.6.2024 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 122, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të shkollës 9-vjeçare 'Picar', Bashkia Vorë, dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese", të ndryshuar | 10584 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 345, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 239, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kavajë", të ndryshuar | 10584 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 5.6.2024 | Për disa shtesa në vendimin nr. 145, datë 11.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë", të ndryshuar | 10585 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 5.6.2024 | Për disa shtesa në vendimin nr. 503, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak", të ndryshuar | 10586 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall", të ndryshuar | 10586 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 255, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Durrës", të ndryshuar | 10587 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 350, datë 5.6.2024 | Për një ndryshim dhe një shtesë në vendimin nr. 199, datë 6.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin te bashkitë Tiranë dhe Krujë të njësive të banimit në ndërtesa (pallat)" | 10587 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 5.6.2024 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 236, datë 14.4.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të godinës së kopshtit publik dhe të godinës së Bashkisë Vorë, Bashkia Vorë, dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese", të ndryshuar | 10589 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 5.6.2024 | Për kalimin në pronësi te bashkitë Durrës, Shijak, Vorë, Rrogozhinë, Kamzë dhe Mirditë të objekteve arsimore................................................ | 10589 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 353, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 499, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), Njësia Administrative Laç dhe Mamurras, Bashkia Kurbin, dhe caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese", të ndryshuar .................................. | 10591 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 5.6.2024 | Për disa shtesa në vendimin nr. 412, datë 15.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Kamzë dhe Lezhë", të ndryshuar................................................................................................ | 10591 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 355, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 446, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të godinës së ish-prefekturës, Bashkia Kavajë, dhe caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese" ........................................ | 10592 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 356, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore", të ndryshuar................................. | 10592 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 357, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 89, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të godinave, spitali 'Shenjta Mari' dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-spitali infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, dhe caktimin e Bashkisë Mirditë si njësi zbatuese", të ndryshuar................................................................................................ | 10593 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 358, datë 5.6.2024 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 500, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të një objekti arsimor në Bashkinë Vorë dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese", të ndryshuar ..................... | 10593 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 359, datë 5.6.2024 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë", të ndryshuar............................................................... | 10594 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 5.6.2024 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 491, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit të qendrave shëndetësore në Bashkinë Kurbin dhe caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese", të ndryshuar................................................................... | 10594 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 361, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 206, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të stacionit të zjarrfikëses dhe të godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, dhe caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese", të ndryshuar............................................................................ | 10595 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 362, datë 5.6.2024 | Për kalimin te Bashkia Tiranë të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) | 10596 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 363, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 279, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak, dhe caktimin e Bashkisë Shijak si njësi zbatuese", të ndryshuar | 10597 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 364, datë 5.6.2024 | Për kalimin te Bashkia Tiranë të njësive individuale të banimit............ | 10597 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 365, datë 5.6.2024 | Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 166, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamzë dhe caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese", të ndryshuar............................................................................ | 10599 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 366, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona '5 Maji', dhe Njësinë Administrative 6, zona 'Kombinat', Bashkia Tiranë", të ndryshuar................................................................. | 10599 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 367, datë 5.6.2024 | Për kalimin në pronësi te Bashkia Tiranë të objekteve publike............. | 10600 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 368, datë 5.6.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 749, datë 9.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit dhe caktimin e Institutit të Ndërtimit si njësi zbatuese", të ndryshuar.......................... | 10601 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 5.6.2024 | Për kalimin te Bashkia Durrës të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) ........................................................................................ | 10601 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 370, datë 5.6.2024 | Për disa shtesa në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar....................................................................... | 10603 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 5.6.2024 | Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar......................................................................................... | 10604 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 373, datë 5.6.2024 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", të ndryshuar.............................................................. | 10619 |

**LIGJ**
**Nr. 52/2024**

# PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE ME NDIKIM NË ENERGJI[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti**

Ky ligj përcakton detyrimet që aplikohen për produktet me ndikim në energji të vendosura në treg ose të vëna në shërbim në lidhje me:

a) etiketimin e tyre nga pikëpamja energjetike;

b) dhënien e informacionit standard të produktit për eficiencën e energjisë;

c) konsumin e energjisë dhe të burimeve të tjera gjatë përdorimit;

ç) informacionin plotësues për produktin, duke mundësuar që përdoruesit fundorë (blerësit fundorë) të mund të zgjedhin produkte bazuar në performancën e tyre energjetike, me qëllim reduktimin e konsumit të tyre të energjisë.

Neni 2
**Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për produkte që gjatë përdorimit kanë një ndikim të rëndësishëm, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për konsumin e energjisë dhe, sipas rastit, për burimet e tjera kryesore.

2. Produktet me ndikim në energji identifikohen përmes akteve nënligjore, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji.

3. Ky ligj nuk zbatohet për:

a) produktet e përdorura, përveçse kur importohen;

b) çdo mjet transporti për persona ose mallra.

4. Produktet e përdorura që importohen duhet të jenë të pajisura me etiketat dhe informacionin e kërkuar sipas këtij ligji.

Neni 3
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Bërje e disponueshme e produktit në treg" ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

2. "Burime të tjera kryesore" janë uji, kimikatet ose çdo substancë tjetër e konsumuar nga një produkt në përdorim normal.

3. "Dokumentacion teknik" është dokumentacioni i mjaftueshëm për t'u mundësuar autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut të vlerësojnë saktësinë e etiketës dhe të skedës së informacionit të një produkti, duke përfshirë raportet e testimit ose dëshmi të ngjashme teknike.

4. "Eficienca e energjisë" ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi që rregullon eficiencën e energjisë.

5. "Etiketë e rishkallëzuar" është një etiketë për një grup produktesh të caktuar, që ka pësuar rishkallëzim dhe është i dallueshëm nga etiketat përpara rishkallëzimit, duke ruajtur një gjurmueshmëri të dukshme të të gjitha etiketave.

6. "Etiketë" është një diagram grafik, qoftë në formë të shtypur ose elektronike, duke përfshirë një shkallë të mbyllur, duke përdorur vetëm shkronjat nga "A" në "G", çdo shkronjë që përfaqëson një klasë dhe çdo klasë që korrespondon me kursimet e energjisë, në shtatë ngjyra të ndryshme nga jeshile e errët në të kuqe, për të informuar klientët për eficiencën e energjisë dhe konsumin e energjisë; ai përfshin etiketat e rishkallëzuara dhe etiketat me më pak klasa dhe ngjyra, sikurse specifikohet në aktet nënligjore respektive.

[1] Ky ligj është përafruar plotësisht me rregulloren (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 4 korrik 2017, "Për përcaktimin e kuadrit ligjor për etiketimin e energjisë dhe shfuqizimin e direktivës 2010/30/BE". Numri CELEX 32017R1369, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 198, datë 28.7.2017, f. 1–23.

7. "Furnizues" është prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar në Shqipëri apo importuesi, i cili vendos ose vë në shërbim produktin në tregun shqiptar. Në mungesë të tyre konsiderohet furnizues çdo person fizik ose juridik, që vendos në treg ose vë në shërbim produkte të mbuluara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

8. "Grup produkti" është një grup produktesh që kanë të njëjtin funksionalitet kryesor.

9. "Identifikues modeli" është kodi, zakonisht alfanumerik, i cili dallon një model produkti specifik nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose me të njëjtin emër të furnizuesit.

10. "Importues" ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi, që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

11. "Informacion plotësues" është çdo informacion tjetër që lidhet me vlerësimin e performancës energjetike dhe mjedisore të një produkti, bazuar në të dhëna të matshme.

12. "Klient" është një person fizik ose juridik, që blen, merr me qira ose merr një produkt për përdorim vetjak, pavarësisht nëse vepron për qëllime që janë jashtë tregtisë, biznesit, zanatit ose profesionit të tij.

13. "Model" është një version i një produkti tek i cili të gjitha njësitë ndajnë të njëjtat karakteristika teknike, respektivisht për etiketën dhe skedën e informacionit dhe të njëjtin numër identifikues modeli.

14. "Modeli ekuivalent" është një model që ka të njëjtat karakteristika teknike të rëndësishme për etiketën dhe të njëjtën fletë informacioni të produktit, por që vendoset në treg ose vihet në shërbim nga i njëjti furnizues, si një model tjetër me një identifikues modeli të ndryshëm.

15. "Ndikim i drejtpërdrejtë" është ndikimi i produkteve që konsumojnë energji gjatë përdorimit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

16. "Ndikim i tërthortë" është ndikimi i produkteve që nuk konsumojnë energji, por që gjatë përdorimit të tyre ndihmojnë në ruajtjen e energjisë.

17. "Organizëm evropian i notifikuar" ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi, që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

18. "Përdorim i paligjshëm i etiketës" është përdorimi i etiketës në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

19. "Përdorues fundor" është personi që përdor produktin dhe për të cilin është parashikuar përdorimi i këtij produkti.

20. "Përfaqësues i autorizuar" ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

21. "Produkt me ndikim në energji" ose "produkt" është çdo mall i vendosur në treg ose në shërbim, që gjatë përdorimit ndikon në konsumin e energjisë, duke përfshirë edhe pjesët e parashikuara për t'u përfshirë në produktet me ndikim në energji, që mbulohen nga ky ligj dhe që janë vendosur në treg dhe/ose janë vënë në shërbim, si pjesë të veçanta për përdoruesin fundor dhe për të cilat performanca mjedisore mund të vlerësohet në mënyrë të pavarur.

22. "Produktet e përdorura" janë produkte, të cilat kanë qenë të çliruara për qarkullim të lirë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

23. "Prodhues" ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi, që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

24. "Rishkallëzimi" është një ndryshim që i bën më të rrepta kërkesat për arritjen e klasës së energjisë në një etiketë për një grup të caktuar produktesh.

25. "Sistem" është një kombinim i disa mallrave, të cilat, kur bashkohen, kryejnë një funksion specifik në një mjedis të caktuar dhe eficienca energjetike e të cilit mund të përcaktohet më pas si një njësi e vetme.

26. "Skedë informative" është një tabelë standarde e informacionit në lidhje me një produkt, në formë të shtypur ose elektronike.

27. "Standard i harmonizuar" janë standardet evropiane, sikurse janë adoptuar dhe janë për t'u aplikuar sipas legjislacionit të harmonizuar të Bashkimit Evropian.

28. "Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut" është Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut (ISHMT) të produkteve të destinuara për konsumatorët.

29. "Shitje në distancë" është oferta për shitje ose marrje me qira nëpërmjet porosive me postë, katalog, internet, telemarketing ose me ndonjë metodë tjetër me të cilën klienti potencial nuk mund të pritet të shohë në mënyrë të drejtpërdrejtë produktin që kërkon të blejë.

30. "Tolerancë verifikimi" është devijimi maksimal i pranueshëm i rezultateve të matjes dhe llogaritjes së testeve të verifikimit të kryera nga ose në emër të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut, krahasuar me vlerat e parametrave të deklaruara ose të publikuara, duke reflektuar devijimin që rrjedh nga laboratori.

31. "Tregtar" është shitësi me pakicë ose çdo person tjetër, i cili shet, jep me qira, ofron shitje me këste apo ekspozon produkte për përdoruesit fundorë.

32. "Vendosje në treg" ka të njëjtin kuptim, sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi, që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

33. "Vënie në shërbim" është përdorimi për herë të parë i produktit, sipas qëllimit të tij të parashikuar.

Neni 4
**Lëvizja e lirë**

Nuk ndalohet, kufizohet ose pengohet vendosja në treg a vënia në shërbim e produkteve, të cilat mbulohen dhe janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

KREU II
KËRKESAT PËR INFORMACIONIN

Neni 5
**Detyrimi i përgjithshëm**

1. Furnizuesit dhe tregtarët përmbushin detyrimet e përcaktuara në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji dhe vendosin në treg dhe/ose në shërbim produkte me ndikim në energji, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Ndalohet vendosja apo shfaqja e etiketave, markave, simboleve apo mbishkrimeve të tjera që nuk janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, të cilat mund të shkaktojnë konfuzion ose të çorientojnë përdoruesin fundor lidhur me konsumimin e energjisë së produkteve me ndikim në energji ose, sipas rastit, të burimeve të tjera kryesore gjatë përdorimit.

3. Furnizuesit dhe tregtarët janë të detyruar:

a) t'i referohen klasit të eficiencës së energjisë së produktit dhe gamës së klasave energjetike të disponueshme në etiketë, në reklamat vizuale ose në skedat teknike promovuese, për një model specifik, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore përkatëse;

b) të bashkëpunojnë me autoritetin përgjegjës të mbikëqyrjes së tregut dhe të marrin masa të menjëhershme për të korrigjuar çdo rast mospërputhjeje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet përkatëse nënligjore, që bien nën përgjegjësinë e tyre, me nismën e tyre ose kur kërkohet ta bëjnë këtë nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut;

c) që për produktet që nuk mbulohen nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, si dhe për produktet që nuk kanë ndikim në energji, të mos furnizojnë ose të shfaqin etiketa që imitojnë etiketat e parashikuara në këtë ligj dhe aktet përkatëse nënligjore.

4. Shkronja "c" e pikës 3 të këtij neni nuk përfshin etiketat e parashikuara në legjislacionin kombëtar, përveç rasteve kur ato etiketa parashikohen në aktet nënligjore përkatëse, sipas këtij ligji.

5. Skemat për nxitjen e blerjeve të produkteve të specifikuara në aktet ligjore dhe nënligjore me subvencionim nga buxheti i shtetit do të realizohen duke synuar dy klasat më të larta të eficiencës së energjisë, të disponueshme gjerësisht ose klasat më të larta, siç përcaktohet në aktet nënligjore për produkte specifike.

Neni 6
**Informacioni**

1. Informacioni sigurohet veçanërisht nëpërmjet etiketimit, skedës informative dhe informacionit plotësues, duke i mundësuar përdoruesit fundor zgjedhjen e produkteve më eficiente. Informacioni duhet të jetë në gjuhën shqipe, i saktë dhe i kuptueshëm.

2. Furnizuesit dhe tregtarët, sipas rolit të përgjegjësisë së tyre, sigurojnë në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij informacionin në lidhje me konsumin e energjisë elektrike, format e tjera të energjisë dhe, sipas rastit, burimet e tjera kryesore, si dhe informacionin plotësues që i jepet përdoruesit fundor nëpërmjet skedës informative dhe etiketës për produkte që ofrohen për shitje, qira, blerje me këste ose që ekspozohen te përdoruesi fundor, në

mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nëpërmjet shitjes në distancë, përfshirë internetin.

3. Informacioni, i referuar në pikën 2 të këtij neni, kërkohet për produkte të instaluara, vetëm kur kërkohet nga akti nënligjor përkatës.

4. Kur në një publicitet për një model specifik të produktit me ndikim në energji, që mbulohet nga një akt nënligjor, sipas nenit 7 të këtij ligji, jepet informacion lidhur me çmimin ose ndikimin e këtij produkti në energji, publiciteti përfshin edhe një referencë për klasën e eficiencës së energjisë së këtij produkti.

5. Çdo material teknik promovues në lidhje me produktin me ndikim në energji, që përshkruan parametra specifikë/teknikë të produktit, siç janë manuale teknike dhe broshura të prodhuesit, të printuara apo nëpërmjet internetit, duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe t'u jepet përdoruesve fundorë së bashku me informacionin e nevojshëm për konsumin e energjisë ose të bëjë referencë në klasën e eficiencës së energjisë të produktit.

Neni 7

**Produkti, etiketa dhe skeda informative**

1. Produktet, hollësitë për etiketën dhe skedën informative, përfshirë edhe procedurën për verifikimin e konformitetit për çdo tip produkti me ndikim në energji përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë. Vendimi përcakton në mënyrë të veçantë:

a) përkufizimin e saktë të tipit të produkteve që përfshihen;

b) standardet dhe metodat e matjes që përdoren për të përftuar informacionin, referuar në nenin 1 të këtij ligji;

c) detajet për dokumentacionin e kërkuar teknik;

ç) disenjimin dhe përmbajtjen e etiketës, e cila duhet të ketë karakteristika disenjimi sa më të njëtrajtshme, përmes grupeve të produkteve dhe, në çdo rast, të jetë qartësisht e lexueshme dhe e dukshme. Formati i etiketës do të mbajë si bazë klasifikimin, duke përdorur shkronjat nga "A" në "G". Hapat e klasifikimit korrespondojnë me kursimin e energjisë dhe kostos nga pikëpamja e përdoruesit fundor.

Kur për një grup të caktuar produktesh, modelet që u përkasin klasave energjetike më të ulëta nuk lejohen më të vendosen në treg ose të vihen në shërbim për shkak të një mase në kuadër të projektimit ekologjik, klasa ose klasat në fjalë do të tregohen në etiketë, sikurse specifikohet në aktin përkatës nënligjor;

d) vendin ku etiketa fiksohet në produkt, si dhe mënyrën nëpërmjet të cilës sigurohet etiketa dhe/ose informacioni përpara blerjes së produktit nga përdoruesi fundor potencial në rastet e ofrimit nëpërmjet shitjes në distancë. Sipas rastit, do të parashikohet që etiketa t'i bashkëngjitet produktit ose të printohet në paketimin e produktit apo në katalogët, në rastin e shitjes në distancë;

dh) përmbajtjen dhe, sipas rastit, formatin dhe hollësi të tjera në lidhje me skedën informative ose informacionin, referuar në nenet 6, 8 dhe 9, pika 4, të këtij ligji. Informacioni në etiketë është i përfshirë edhe në skedën informative;

e) përmbajtjen specifike të etiketës në rastet e publicitetit, përfshirë, sipas rastit, klasën e energjisë dhe nivelet përkatëse të performancës së produktit në fjalë në një formë të lexueshme dhe të dukshme;

ë) nivelin e saktësisë në deklarimin e etiketës dhe të skedës informative;

f) detyrimet e tjera specifike të tregtarëve;

g) detyrimet e tjera specifike të furnizuesve;

gj) detyrimet e tjera për reklamimin e produkteve në faqet dhe platformat *online;*

h) metodat e matjes;

i) procedurën për verifikimin e konformitetit.

2. Për produkte specifike, akti nënligjor përkatës mund të përmbajë kërkesa të detajuara, që synojnë të rregullojnë procesin e etiketimit apo regjistrimit të tyre në regjistër publik, duke mbuluar çdo aspekt të mundshëm teknik.

Neni 8

**Përdorimi i etiketave të rishkallëzuara**

1. Kur në përputhje me aktin nënligjor, të hartuar sipas nenit 7 të këtij ligji, një etiketë është rishkallëzuar:

a) furnizuesi, kur vendos një produkt në treg, do t'i sigurojë tregtarit si etiketat ekzistuese, ashtu edhe ato të rishkallëzuara, së bashku me fletët e informacionit të produktit, për një periudhë që fillon katër muaj përpara datës së specifikuar në aktin përkatës nënligjor për fillimin e ekspozimit të etiketës së rishkallëzuar.

Duke përjashtuar paragrafin sa më sipër, nëse etiketa ekzistuese dhe e rishkallëzuar kërkon testime

të ndryshme të modelit, furnizuesi mund të zgjedhë të mos furnizojë etiketën ekzistuese me njësi modelesh të vendosura në treg ose të vëna në shërbim gjatë periudhës katërmujore përpara datës së përcaktuar në aktin përkatës, të deleguar për fillimin e shfaqjes së etiketës së rishkallëzuar nëse asnjë njësi, që i përket të njëjtit model ose modeleve ekuivalente, nuk është vendosur në treg ose është vënë në shërbim përpara fillimit të periudhës katërmujore. Në këtë rast, tregtari nuk do t'i ofrojë ato njësi për shitje përpara kësaj date. Furnizuesi njofton tregtarin në fjalë për këtë pasojë sa më shpejt të jetë e mundur, kur ai përfshin njësi të tilla në ofertat e tij për tregtarët.

b) furnizuesi, për produktet e vendosura në treg ose të vëna në shërbim përpara periudhës katërmujore, do të dorëzojë etiketën e rishkallëzuar me kërkesë nga tregtari në përputhje me pikën 6 të nenit 9 që nga fillimi i asaj periudhe. Për produkte të tilla tregtari do të marrë një etiketë të rishkallëzuar.

Duke përjashtuar paragrafin sa më sipër:

i. një tregtar, i cili nuk është në gjendje të marrë një etiketë të rishkallëzuar në përputhje me paragrafin e mësipërm për njësitë tashmë në stokun e tij për shkak se furnizuesi ka ndërprerë aktivitetet e tij, do të lejohet t'i shesë ato njësi ekskluzivisht me etiketën e pandryshuar deri në nëntë muaj pas datës së përcaktuar në aktin përkatës, të deleguar për fillimin e shfaqjes së etiketës së rishkallëzuar; ose

ii. nëse etiketa e papërshkallëzuar dhe e rishkallëzuar kërkon testime të ndryshme të modelit, furnizuesi përjashtohet nga detyrimi për të furnizuar një etiketë të rishkallëzuar për njësitë e vendosura në treg ose të vëna në shërbim përpara periudhës katërmujore, nëse nuk ka njësi që i përkasin të njëjtit model ose modeleve ekuivalente, që vendosen në treg ose vihen në shërbim pas fillimit të periudhës katërmujore. Në këtë rast, tregtari do të lejohet t'i shesë ato njësi ekskluzivisht me etiketën e pandryshuar deri në nëntë muaj pas datës së specifikuar në aktin përkatës, të deleguar për fillimin e shfaqjes së etiketës së rishkallëzuar.

c) tregtari do të zëvendësojë etiketat ekzistuese në produktet e ekspozuara, si në dyqane, ashtu edhe në internet, me etiketat e rishkallëzuara, brenda 14 ditëve pune, pas datës së specifikuar në aktin përkatës nënligjor për fillimin e shfaqjes së etiketës së rishkallëzuar. Tregtari nuk shfaq etiketat e rishkallëzuara përpara kësaj date.

2. Rishkallëzimi i etiketave të printuara në ambalazh, për rastet e ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, do të rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## KREU III
## DETYRIMET E FURNIZUESVE DHE TË TREGTARËVE

### Neni 9
### **Detyrimet e furnizuesve**

1. Furnizuesit, që vendosin në treg ose vënë në shërbim produkte sipas kërkesave të nenit 7 të këtij ligji, sigurojnë etiketën dhe skedën informative në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe me aktin nënligjor përkatës në zbatim të këtij ligji.

2. Furnizuesi përgatit dokumentacionin teknik, që duhet të jetë i mjaftueshëm për të mundësuar vlerësimin e saktësisë së informacionit, që përmban etiketa dhe skeda informative.

3. Dokumentacioni teknik përfshin:

a) një përshkrim të përgjithshëm të produktit;

b) sipas rastit, rezultatet e llogaritjeve të kryera gjatë projektimit;

c) raportet e testeve dhe, sipas rastit, edhe ato të kryera nga organizma evropianë të notifikuar apo degë të tyre të regjistruara në Shqipëri dhe të miratuara nga ministri përgjegjës, sipas legjislacionit përkatës;

ç) kur vlerat janë përdorur për modele të ngjashme, referimet për identifikimin e këtyre modeleve.

Për këtë qëllim, furnizuesi mund të përdorë dokumentacionin teknik, të përgatitur në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat teknike përkatëse.

4. Pasi njësia e fundit e një modeli të jetë hedhur në treg, furnizuesi ruan informacionin në lidhje me atë model për një periudhë 15-vjeçare. Aty ku është e përshtatshme, në lidhje me jetëgjatësinë mesatare të një produkti, një periudhë më e shkurtër ruajtjeje mund të parashikohet nga aktet nënligjore përkatëse.

5. Furnizuesit vënë në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut dokumentacionin teknik, në formë elektronike ose fizike, brenda 10 ditëve pune, pas marrjes së kërkesës nga kjo strukturë.

6. Furnizuesit sigurojnë falas etiketat e nevojshme dhe informacionin për produktin, sipas kërkesës së tregtarëve.

7. Pavarësisht sistemit të zgjedhur nga furnizuesi për shpërndarjen e etiketave, furnizuesi i shpërndan menjëherë etiketat dhe në çdo rast brenda pesë ditëve pune me kërkesë të tregtarëve.

8. Përveç etiketave, furnizuesi siguron dhe skedën informative të produktit.

9. Furnizuesi përfshin një skedë informative në të gjitha broshurat e produktit. Kur furnizuesi nuk siguron broshura të produktit, ai siguron skeda informative së bashku me materiale të tjera shpjeguese që shoqërojnë produktin.

10. Furnizuesi është përgjegjës për saktësinë e etiketave dhe skedave informative që ai shpërndan.

11. Publikimi i informacionit të dhënë në etiketë ose në skedën informative, çdo publicitet për produktin përkatës me ndikim në energji, si dhe çdo material teknik promovues, referuar përkatësisht në pikat 4 dhe 5 të nenit 6 të këtij ligji, konsiderohet i miratuar nga furnizuesi.

12. Pasi një njësi e një modeli të jetë në shërbim, furnizuesi kërkon në çdo rast pëlqimin nga klienti në lidhje me çdo ndryshim që synohet të përfshihet në njësi me anë të përditësimeve, të cilat do të ishin të dëmshme për parametrat e eficiencës së energjisë për atë njësi, siç përcaktohet në aktin përkatës nënligjor. Furnizuesi informon klientin për objektivin e përditësimit dhe për ndryshimet në parametra, duke përfshirë çdo ndryshim në klasën e etiketës. Për një periudhë proporcionale me jetëgjatësinë mesatare të produktit, furnizuesi ka detyrimin t'i japë klientit mundësinë e refuzimit të përditësimit, duke shmangur humbjen e funksionalitetit.

13. Furnizuesi nuk do të vendosë në treg produkte që janë projektuar, në mënyrë të tillë që performanca e një modeli të ndryshohet automatikisht në kushtet e testimit, me qëllim arritjen e një niveli më të favorshëm për cilindo nga parametrat e specifikuar në aktin përkatës nënligjor ose të përfshirë në dokumentacionin që shoqëron produktin.

Neni 10
**Detyrimet e tregtarëve**

1. Tregtarët paraqesin në mënyrë të dukshme e të lexueshme etiketat dhe mundësojnë që skeda informative të jetë përfshirë në broshurën e produktit ose në çdo material tjetër shpjegues që shoqëron produktin kur shitet te përdoruesi fundor, duke përfshirë dhe shitjen në distancë në internet.

2. Kur ekspozohet një produkt i mbuluar nga një akt nënligjor, në zbatim të këtij ligji, tregtari bashkëngjit etiketën e përshtatshme në gjuhën shqipe dhe në një pozicion qartësisht të dukshëm, siç specifikohet në aktin nënligjor përkatës.

KREU IV
MBIKËQYRJA E TREGUT

Neni 11
**Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut**

1. Detyrimi për kontrollin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji kryhet nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

2. Kur ka dyshime që informacioni i dhënë në etiketa ose në skeda informative nuk është i saktë, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut u kërkon furnizuesve të vërtetojnë saktësinë e informacionit të dhënë.

3. Struktura përgjegjëse kryen kontrolle:

a) me anë të kontrollit të dokumentacionit; dhe

b) kur është e përshtatshme, me anë të kontrolleve fizike e laboratorike në bazë të mostrave.

4. Të gjitha veprimtaritë e nevojshme për të garantuar zbatimin efektiv të këtij ligji do të përfshihen në programin vjetor të inspektimit për vitin pasardhës.

5. Programi vjetor i inspektimit hartohet nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut dhe miratohet nga ministria përgjegjëse për tregtinë. Një kopje e programit i dërgohet ministrisë përgjegjëse për energjinë.

6. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut raporton brenda datës 31 mars te ministria përgjegjëse për tregtinë dhe te ministria përgjegjëse për energjinë për numrin e inspektimeve të kryera për vitin kalendarik paraardhës. Kjo e fundit raporton te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë sipas detyrimeve dhe parashikimeve në fuqi.

7. Formati i raportimit, sipas pikës 6, hartohet nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut dhe miratohet nga ministria përgjegjëse për tregtinë.

Neni 12
**Kompetencat e strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut**

1. Strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, për zbatimin e këtij ligji, përveç kompetencave të dhëna nga legjislacioni në fuqi, që rregullon sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore, si dhe tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, i jepen edhe kompetencat e mëposhtme:

a) urdhëron sjelljen e etiketave dhe skedave informative në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) kërkon nga furnizuesi dokumentacionin teknik kur ka arsye të dyshojë për pasaktësi në informacionin e etiketave ose të skedave informative;

c) merr mostra dhe kryen teste të konformitetit për saktësinë e informacionit në laboratorë të akredituar për këtë qëllim. Në rastet kur në bazë të një raporti testimi zbulohet se furnizuesi nuk ka dhënë informacionin e saktë ose ai është çorientues, të gjitha shpenzimet për kryerjen e raportit të testimit mbulohen nga furnizuesi. Në të kundërt, shpenzimet mbulohen nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut;

ç) urdhëron furnizuesin të marrë masa për të siguruar informacionin e saktë në etiketë ose skedën informative, brenda 10 ditëve pune, kur ka evidenca që produkti nuk është në përputhje me informacionin e dhënë;

d) urdhëron tërheqjen nga tregu, ndalon shitjen ose lëvizjen e lirë të pajisjes në rast se vazhdon shkelja referuar në shkronjën "dh" të këtij neni. Në raste të tilla struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut njofton ministrinë përgjegjëse për tregtinë/energjinë, së bashku me shpjegimet për këto masa;

dh) urdhëron me shkrim furnizuesin të ndalojë shkeljen në rastet kur etiketa është bashkëngjitur në mënyrë të paligjshme;

e) bashkëpunon dhe asiston në vlerësimin e shkeljeve të identifikuara nga autoriteti i doganave;

ë) vendos masa administrative në përputhje me këtë ligj;

f) siguron që prezantimi i të gjitha etiketave të reja dhe rishkallëzimi i etiketave të shoqërohet me fushata informuese edukative dhe promovuese për etiketat e energjisë, duke bashkëpunuar me agjencinë përgjegjëse për eficiencën e energjisë. Nëse vlerësohet e përshtatshme, ky proces realizohet në bashkëpunim me furnizuesit dhe tregtarët.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për tregtinë dhe të ministrit përgjegjës për energjinë, miraton afatet dhe procedurën e detajuar që ndiqet nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për zbatimin e kompetencave të saj.

Neni 13
**Procedura për trajtimin e produkteve që paraqesin rrezik**

1. Kur autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut disponon arsye të mjaftueshme për të vërtetuar se një produkt i mbuluar nga ky ligj paraqet rrezik për aspektet e mbrojtjes së interesit publik, siç janë aspektet e mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, do të kryejë një vlerësim për produktin në fjalë, që mbulon të gjitha kërkesat e etiketimit të energjisë, që lidhen me rrezikun, dhe ato të përcaktuara në këtë ligj ose në aktin përkatës nënligjor. Furnizuesit dhe tregtarët do të bashkëpunojnë sipas nevojës me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për realizimin e vlerësimit.

2. Kur gjatë vlerësimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut konstaton se produkti nuk përputhet me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj ose në aktin përkatës nënligjor, ai do t'i kërkojë pa vonesë furnizuesit ose, kur është e përshtatshme, tregtarit të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura korrigjuese:

a) për të sjellë produktin në përputhje me këto kërkesa;

b) për të tërhequr produktin nga tregu; ose,

c) për ta tërhequr atë brenda një periudhe të arsyeshme, në përpjesëtim me natyrën e rrezikut, brenda afatit të vlerësuar prej tyre.

3. Kur autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut konsideron se një rast mospërputhjeje, siç përmendet në pikën 2 të këtij neni, nuk është i kufizuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, ai njofton Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe palët e kontraktuara për rezultatet e vlerësimit, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, dhe për veprimet që ata kanë kërkuar që furnizuesi ose tregtari duhet të marrë.

4. Furnizuesi ose, kur është e përshtatshme, tregtari ndërmerr të gjitha veprimet e duhura

korrigjuese ose kufizuese në përputhje me pikën 2 të këtij neni për të gjitha produktet e konstatuara, që ka bërë të disponueshme në treg.

5. Kur furnizuesi ose, sipas rastit, tregtari nuk ndërmerr veprime të duhura korrigjuese brenda periudhës së përmendur në pikën 2 të këtij neni, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar ose kufizuar disponueshmërinë e produktit në treg ose për të tërhequr produktin nga tregu.

6. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut informon Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe palët e tjera kontraktuese për masat e marra, në përputhje me pikën 5 të këtij neni, brenda 2 ditëve pune, prej momentit të marrjes së masave. Informacioni i dërguar përfshin të gjitha detajet e disponueshme, si dhe:

a) të dhënat e nevojshme për identifikimin e produktit që nuk përputhet;

b) origjinën e produktit;

c) natyrën e mospërputhshmërisë së pretenduar dhe rrezikun e përfshirë;

ç) natyrën dhe kohëzgjatjen e masave kombëtare të marra dhe argumentet e paraqitura nga furnizuesi ose, kur është e përshtatshme, tregtari.

Në veçanti, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut qartëson nëse mospërputhja është për shkak se produkti nuk arrin të përmbushë kërkesat në lidhje me aspektet e mbrojtjes së interesit publik, të përcaktuara në këtë ligj, apo për shkak të mangësive në standardet e harmonizuara, që japin një supozim mbi konformitetin.

7. Kur brenda 60 ditëve kalendarike nga marrja e informacionit, të përmendur në pikën 5 të këtij neni, nuk është ngritur asnjë kundërshtim nga një palë kontraktuese ose nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në lidhje me një masë provizore të marrë nga autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut, ajo masë do të konsiderohet të jetë e justifikuar.

8. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut siguron që masat e ndërmarra kufizuese, të tilla si tërheqja e produktit nga tregu janë realizuar brenda një periudhe sa më të shkurtër.

9. Kur standardet e harmonizuara të Bashkimit Evropian zbatohen gjatë vlerësimit të konformitetit të një produkti, modeli do të supozohet se është në përputhje me kërkesat përkatëse të matjes dhe llogaritjes së aktit nënligjor.

10. Autoritetet doganore, kur konstatojnë produkte që nuk janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, njoftojnë autoritetin përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut, i cili mund të urdhërojë marrjen e masave të parashikuara në këtë ligj për garantimin e sigurisë së përdoruesve fundorë.

11. Për çdo procedurë të nisur nga një palë kontraktuese, Autoriteti Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut njofton Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe palët e tjera kontraktuese për çdo masë të ndërmarrë për produktin për të cilin nis procedura lidhur me mospërputhshmërinë dhe në rast mosmarrëveshjeje, me masën kombëtare të kundërshtimeve të njoftuara prej të tyre.

## KREU V
## KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

### Neni 14
### **Kundërvajtjet administrative**

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut si më poshtë:

a) për shkelje të pikave 4 dhe 5 të nenit 6 të këtij ligji me gjobë në masën 200 000 lekë;

b) për shkelje të parashikimeve të nenit 8 të këtij ligji me gjobë në masën 300 000 lekë;

c) për shkelje të pikave 2, 6, 7, 8 deri 9 të nenit 9 të këtij ligji me gjobë në masën 350 000 lekë;

ç) për shkelje të kërkesave të parashikuara në shkronjat "c", "d", "ë", "f", "g" dhe "gj" të nenit 7 dhe të pikave 2 e 3 të nenit 9 të këtij ligji me gjobë në masën 300 000 lekë;

d) për shkelje të pikave 2 dhe 3 të nenit 5 dhe të pikave 5 dhe 10 të nenit 9 të këtij ligji me gjobë në masën 350 000 lekë;

dh) për shkelje të parashikimeve të nenit 10 me gjobë në masën 300 000 lekë;

e) për moszbatimin e masave, referuar në parashikimet e neneve 12 dhe 13 të këtij ligji me gjobë në masën 350 000 lekë;

ë) për bizneset e vogla, të klasifikuara si rezultat i xhiros vjetore, vlera e gjobës për secilën prej shkeljeve të mësipërme është 150 000 lekë.

2. Kur edhe pas marrjes së masave, sipas parashikimeve të këtij neni, furnizuesi ose tregtari rezulton se përsërit shkeljen për të njëjtin produkt, atëherë masat e gjobës dyfishohen.

Neni 15
**Ankimi**

1. Ankimi administrativ kundër vendimit për shkeljen administrative paraqitet dhe shqyrtohet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Kur pas përfundimit të procedurës së përcaktuar në nenin 13, pikat 4 dhe 5, ngrihen kundërshtime kundër një mase të marrë nga një palë kontraktuese, ose kur Sekretariati konsideron se një masë kombëtare është në kundërshtim me vendimet e marra nga Komuniteti i Energjisë**,** Sekretariati do të konsultohet pa vonesë me palën kontraktuese dhe furnizuesin ose, kur është e përshtatshme, tregtarin dhe do të vlerësojë masën kombëtare

3. Mbi bazën e rezultateve të atij vlerësimi, Sekretariati rekomandon nëse masa kombëtare është e justifikuar apo jo dhe mund të sugjerojë një masë alternative të përshtatshme.

4. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut mirëpret vlerësimet dhe rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për produkte të caktuara dhe ndërmerr veprimet e nevojshme për të tërhequr nga tregu ose lejuar në treg produkte që nuk plotësojnë kriteret sipas këtij ligji dhe akteve përkatëse nënligjore.

5. Masat korrigjuese ose kufizuese, në përputhje me pikat 2, 4, 5 ose 9 të nenit 13, ose me pikën 4 të nenit 15, do të shtrihen për të gjitha njësitë e një modeli, që nuk përputhet dhe të modeleve të tij ekuivalente, përveç atyre njësive për të cilat furnizuesi demonstron se ato janë në përputhje.

Neni 16
**Ekzekutimi i vendimit**

1. Vendimi për kundërvajtjen administrative përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga shërbimi përmbarimor në rast se nuk shlyhet në kohë nga personi fizik ose juridik që ka kryer shkeljen.

2. Vendimi bëhet i ekzekutueshëm kur e drejta për ankim nuk është ushtruar brenda afateve kohore të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

3. Të ardhurat që burojnë nga masat administrative derdhen në buxhetin e shtetit.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 17
**Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 1, dhe 8, pika 2, të këtij ligji brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 18
**Shfuqizime**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 68/2012, "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji" shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore, që janë miratuar në përputhje me ligjin nr. 68/2012, "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji", qëndrojnë në fuqi nëse nuk bien ndesh me këtë ligj ose deri kur të zëvendësohen nga akte të tjera respektivisht të këtij ligji.

Neni 19
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.5.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 225, datë 5.6.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

**DEKRET**
**Nr. 225, datë 5.6.2024**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 52/2024, "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Bajram Begaj**

**VENDIM**
**Nr. 337, datë 5.6.2024**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 456, DATË 29.6.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE PËR VENDOSJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK, QË DO TË ZBATOHEN NDAJ TË LICENCUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, TË CILËT USHTROJNË AKTIVITETIN E PRODHIMIT, TRANSMETIMIT, SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin "Për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohet ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", bashkëlidhur vendimit nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 1, të nenit 1, shtohen fjalët "… si dhe të përcaktojë ndërveprimin ndërmjet shoqërive të mësipërme.".

2. Pas pikës 6, të nenit 3, shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

"7. Në këtë vendim, fjalët "në mënyrë proporcionale", kanë kuptimin që në rast të tepricave, sasitë e planifikuara për blerje në treg të parregulluar nga Furnizuesi i Tregut të Lirë të jenë jo më shumë se pesëdhjetë për qind e energjisë elektrike mujore të planifikuar për furnizim, duke i mundësuar Furnizuesit të Tregut të Lirë depozitimin te shoqëria publike të prodhimit të tepricave të energjisë elektrike dhe rimarrjen potenciale të tyre, me qëllim optimizimin e portofolit të dy shoqërive.".

3. Në nenin 12 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) në pikën 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. pas fjalëve "... mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ..." shtohen "... dhe furnizim në tregun e lirë ...";

ii. fjalët " ... ndërsa çmimi i shitjes për njësi miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë" zëvendësohen me " ... ndërsa metodologjia e caktimit të çmimit të furnizimit e shitjes për njësi miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë";

iii. pas paragrafit të parë shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Furnizuesi i Tregut të Lirë, për nevoja të furnizimit të klientëve të saj në treg të lirë, ka të drejtë, në mënyrë proporcionale, ta sigurojë këtë energji në treg të parregulluar dhe/ose të përdorë tepricat/depozitën nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë. Për optimizimin e çmimit të portofolit të furnizimit, profilet e blerjes orare përshtaten bazuar në pritshmërinë e arsyeshme të tregut të energjisë. Rregullat për sigurimin e energjisë elektrike nga tregu i parregulluar, duke përfshirë edhe tregun e ditës në avancë dhe/ose tepricat nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, miratohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.";

b) në pikën 4, fjalia e parë që mbyllet me " ... për t'u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universalë", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Sasia e tepërt nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, pas mbulimit të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose furnizimit të klientëve në tregun e lirë, depozitohet në shoqërinë publike të prodhimit për t'u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universalë.".

II. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 338, datë 5.6.2024**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 167, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, VORË, KAMZË DHE RROGOZHINË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 167, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, në masën 420 669 114 (katërqind e njëzet milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e katërmbëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës dhe Rrogozhinë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 185 021 720 (njëqind e tetëdhjetë e pesë milionë e njëzet e një mijë e shtatëqind e njëzet) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Rrogozhinë i transferohet fondi, në masën 235 647 394 (dyqind e tridhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

b) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Efekti financiar, për vitin 2024, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet bashkive Durrës dhe Rrogozhinë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Durrës dhe Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 339, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 240, DATË 20.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE 'BAGO', BASHKIA KAVAJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 240, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së

pakushtëzuar, në masën 156 464 363 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare "Bago", Bashkia Kavajë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.";

b) Në pikën 3, togfjalëshi "... sipas pikave 1 dhe 2 ..." zëvendësohet me "... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 340, datë 5.6.2024**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3.5, të vendimit nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3.6, me këtë përmbajtje:

"3.6. Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2024, do të jetë në masën 495 066 760.71 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë presje shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 332 281 401,71 (treqind e tridhjetë e dy milionë e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e një presje shtatëdhjetë e një) lekësh pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë;

b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i transferohet fondi prej 162 785 359 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 341, datë 5.6.2024**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 27, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË DHE KURBIN", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të

Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/2, të vendimit nr. 27, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/3 Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, në masën 1 887 000 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në Bashkinë Kurbin, që përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Kurbin në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 342, datë 5.6.2024**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 359, DATË 16.6.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË URËS NË LEZHË DHE CAKTIMIN E BASHKISË LEZHË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 359, datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Lezhë, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i transferohet fondi, në masën 151 838 708 (njëqind e pesëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 343, datë 5.6.2024**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 180, DATË 30.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E PËRGATITJES SË SHESHEVE TË NDËRTIMIT NË BASHKINË KRUJË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 180, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, për financimin e shembjeve të njësive individuale të banimit të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre në Bashkinë Krujë, në masën 33 575 654 (tridhjetë e tre milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, që përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 344, datë 5.6.2024

## PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 122, DATË 2.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE 'PICAR', BASHKIA VORË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 122, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/2 shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/3. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 5 025 207 (pesë milionë e njëzet e pesë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të shkollës 9-vjeçare "Picar", Bashkia Vorë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1, 2, 2.1 dhe 2.2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2, 2/1, 2/2 dhe 2/3 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 345, datë 5.6.2024

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 239, DATË 20.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË KAVAJË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të

Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 239, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, nga Bashkia Kavajë për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni, në masën 192 095 882 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Kavajë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 346, datë 5.6.2024

## PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 145, DATË 11.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË SHIJAK, KAMZË, KAVAJË DHE KRUJË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 145, datë 11.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2 Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, në masën 612 391 723 (gjashtëqind e dymbëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e njëzet e tre) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Kavajë dhe Krujë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi, në masën 21 183 261 (njëzet e një milionë e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 591 208 462 (pesëqind e nëntëdhjetë e një milionë e dyqind e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.";

b) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1 Efekti financiar, për vitin 2024, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe u transferohet bashkive Kavajë dhe Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Kavajë e Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 347, datë 5.6.2024**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 503, DATË 27.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, VORË DHE SHIJAK", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3, të vendimit nr. 503, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pikat 3/1 dhe 3/2, me këtë përmbajtje:

"3/1 Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, nga Bashkia Durrës, në masën 72 409 932 (shtatëdhjetë e dy milionë e katërqind e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, sipas aktekspertizave të thelluara, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3/2 Efekti financiar, për vitin 2024, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 348, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 587, DATË 22.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM DHE RINDËRTIM NË TË NJËJTIN TRUALL", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 5.1, të vendimit nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 5.2, me këtë përmbajtje:

"5.2 Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 435 492 916,20 (katërqind e tridhjetë e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë presje njëzet) lekësh pa TVSH.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 349, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 255, DATË 29.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË DURRËS", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 255, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2 Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, në masën 85 335 793 (tetëdhjetë e pesë milionë e treqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, nga Bashkia Durrës, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 350, datë 5.6.2024**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 199, DATË 6.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN TE BASHKITË TIRANË DHE KRUJË TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT)"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 199, datë 6.4.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalët "...sipas anekseve 1 dhe 2..." zëvendësohen me "...sipas anekseve 1, 2 dhe 3...".

b) Pas aneksit 2, bashkëlidhur vendimit në fuqi, shtohet aneksi 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

LISTA E INVENTARIT TË OBJEKTEVE TË PËRFUNDUARA NË ZONËN “5 MAJ” (TË KOLAUDUARA)

| Nr. | Emërtimi i kontratës | Vlera e objektit sipas kontratës (ndërtim + montim + projektim) | Vlera e situacionit përfundimtar (ndërtim + montim) (pjesa e mbetur) | Vlera e studim projektimit | Vlera e mbikëqyrjes së punimeve | Vlera e kolaudimit të punimeve | Vlera totale | Sipërfaqe total ndërtimi (m²) (pjesa e mbetur) | Sipërfaqe banimi ap. (m²) | Sipërfaqe e njësive të shërbimit | Sipërfaqja e katit -1 | Hapësirë e përbashkët (kat -1 + kat përdhe + kate banimi +kafaz ashensor+ pandus+pasazh) | Ap. 1+1 | Ap. 2+1 | Ap. 3+1 | Total apartamente (Nr) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hartimi i projektit dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e godinës 15A (Seksioni 3) (pjesa e mbetur) | 545,660,000 | 294,118,087.00 | 10,000,000.00 | 4,563,792 | 200,100.00 | 308,881,979 | 9,454.23 | 3,992.30 | 1,171.80 | 2,048.09 | 2,242.04 | 5 | 17 | 14 | 36 |
| 2 | Hartimi i projektit dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e pallatit 19 (pjesa e mbetur) | 408,825,570 | 211,528,287.00 | 16,615,510.00 | 3,526,687 | 150,500.00 | 231,820,984 | 5,596.70 | 1,878.80 | 1,160.70 | 2,011.20 | 546.00 | 4 | 16 | 8 | 28 |
| **TOTALI** | | **954,485,570** | **505,646,374** | **26,615,510** | **8,090,479** | **350,600** | **540,702,963** | **15,051** | **5,871** | **2,333** | **4,059** | **2,788** | **9** | **33** | **22** | **64** |

**Shënim.** Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 199, datë 6.4.2022, “Për kalimin te bashkitë Tiranë dhe Krujë të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), janë kaluar në pronësi të Bashkisë Tiranë 26 apartamente për godinën 15A (Seksioni 2), 28 apartamente për godinën 15A (Seksioni 3) dhe 32 apartamente për godinën 19.

**VENDIM**
**Nr. 351, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 236, DATË 14.4.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË GODINËS SË KOPSHTIT PUBLIK DHE TË GODINËS SË BASHKISË VORË, BASHKIA VORË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 236, datë 14.4.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/2 shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/3. Bashkisë Vorë, për vitin 2024, i transferohet fondi, në masën 15 781 860 (pesëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të godinës së kopshtit publik, Bashkia Vorë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.".

b)Në pikën 3, fjalët "... , sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ..." zëvendësohen me "... , sipas pikave 1, 2, 2/1, 2/2 dhe 2/3 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 352, datë 5.6.2024**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TE BASHKITË DURRËS, SHIJAK, VORË, RROGOZHINË, KAMZË DHE MIRDITË TË OBJEKTEVE ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20, pika 6, e 23, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi te bashkitë Durrës, Shijak, Vorë, Rrogozhinë, Kamzë dhe Mirditë të 9 (nëntë) objekteve arsimore, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkitë Durrës, Shijak, Vorë, Rrogozhinë, Kamzë dhe Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

| Nr. | Qarku | Bashkia | Njësia Administrative | Niveli | Emërtimi | Tipologjia e ndërhyrjes | Financimi i ndërtimit | Sipërfaqja (m²) | Vlera e projektidesë | Vlera e projektit të zbatimit dhe ndërtimit | Vlera e mbikëqyrjes | Vlera e kolaudimit | Vlera totale e objektit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Durrës | Durrës | Sukth | I mesëm | Shkolla e mesme "Dhosi Liperi", Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës | Ndërtim | Bashkimi Evropian - projekti "BE për shkollat" | 1890 | 762,042.75 | 165,353,811.66 | 2,234,470.25 | 224,145.64 | 168,574,470.30 |
| 2 | Durrës | Shijak | Xhafzotaj | 9 - vjeçare + kopsht | Shkolla 9-vjeçare dhe kopshti "Rilindja", Sallmone, Bashkia Shijak | Ndërtim | Bashkimi Evropian - projekti "BE për shkollat" | 1597.6 | 459,000.00 | 98,966,024.40 | 1,456,250.00 | 189,515.73 | 101,070,790.13 |
| 3 | Tiranë | Vorë | Vorë | 9-vjeçare | Shkolla 9-vjeçare Vorë, Bashkia Vorë | Ndërtim | Bashkimi Evropian - projekti "BE për shkollat" | 3525 | 459,000.00 | 151,422,279.70 | 1,456,250.00 | 174,098.31 | 153,511,628.01 |
| 4 | Durrës | Durrës | Durrës | I mesëm | Shkolla e mesme "Olsi Lasko", Bashkia Durrës | Ndërtim | Bashkimi Evropian - projekti "BE për shkollat" | 3231.8 | 356,210.00 | 168,566,398.15 | 3,220,359.38 | 107,600.00 | 172,250,567.53 |
| 5 | Tiranë | Rrogozhinë | Kryevidh | 9-vjeçare + kopsht | Shkolla 9-vjeçare dhe kopshti Kryevidh, Bashkia Rrogozhinë | Ndërtim | Bashkimi Evropian - projekti "BE për Shkollat" | 379 | 286,387.20 | 35,926,879.90 | 1,749,511.20 | 44,947.72 | 38,007,726.02 |
| 6 | Tiranë | Rrogozhinë | Kryevidh | 9-vjeçare + kopsht | Shkolla 9-vjeçare dhe kopshti Rreth-Greth, Bashkia Rrogozhinë | Ndërtim | Bashkimi Evropian - projekti "BE për shkollat" | 331 | 286,387.20 | 30,329,558.90 | 1,749,511.20 | 42,694.41 | 32,408,151.71 |
| 7 | Tiranë | Rrogozhinë | Gosë | 9-vjeçare + kopsht | Shkolla 9-vjeçare dhe kopshti Vilë Bashtovë, Bashkia Rrogozhinë | Ndërtim | Bashkimi Evropian - projekti "BE për shkollat" | 355 | 286,387.20 | 39,013,307.63 | 1,749,511.20 | 46,252.27 | 41,095,458.30 |
| 8 | Tiranë | Kamzë | Paskuqan | Çerdhe | Çerdhe Kamzë, Bashkia Kamzë (riemërtuar çerdhja nr. 4, "Pranverë") | Ndërtim | Bashkimi Evropian - projekti "BE për shkollat" | 653 | 534,331.20 | 57,950,033.40 | 1,744,700.00 | 83,016.90 | 60,312,081.50 |
| 9 | Lezhë | Mirditë | Rubik | Kopsht + çerdhe | Kopshti/çerdhja nr. 1, Rubik, Bashkia Mirditë (riemërtuar kopshti/çerdhja "Bleta Punëtore") | Ndërtim | Bashkimi Evropian - projekti "BE për shkollat" | 631.1 | 680,000.00 | 43,857,594.92 | 1,771,624.75 | 75,901.17 | 46,385,120.84 |

**VENDIM**
**Nr. 353, datë 5.6.2024**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 499, DATË 27.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NJËSIA ADMINISTRATIVE LAÇ DHE MAMURRAS, BASHKIA KURBIN, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 499, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 151 640 413 (njëqind e pesëdhjetë e një milionë e gjashtëqind e dyzet mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH, për rindërtimin në truallin ekzistues të 3 (tri) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 354, datë 5.6.2024**

## PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 412, DATË 15.6.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË KAMZË DHE LEZHË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 412, datë 15.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, nga Bashkia Kamzë, në masën 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, sipas aktekspertizave të thelluara, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

b) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Efekti financiar për vitin 2024 përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 355, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 446, DATË 29.6.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË GODINËS SË ISH-PREFEKTURËS, BASHKIA KAVAJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 446, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi prej 138 922 783 (njëqind e tridhjetë e tetë milionë e nëntëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre) lekësh pa TVSH për financimin e rindërtimit të godinës së ish-prefekturës, Bashkia Kavajë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Kavajë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 356, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2013, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.4, të vendimit nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.5, me këtë përmbajtje:

"2.5 Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2024, të jetë në masën 29 182 978, 59 (njëzet e nëntë milionë e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë presje pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 480 620,59 (katërqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet presje pesëdhjetë e nëntë) lekësh pa TVSH;

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 28 702 358 (njëzet e tetë milionë e shtatëqind e dy mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 357, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 89, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË GODINAVE, SPITALI 'SHENJTA MARI' DHE DREJTORIA E SHËNDETIT PUBLIK (ISH-SPITALI INFEKTIV), NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË MIRDITË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/2, të vendimit nr. 89, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/3. Bashkisë Mirditë, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 4 241 157 (katër milionë e dyqind e dyzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të godinave, spitali "Shenjta Mari" dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), njësia administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, që do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 358, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 500, DATË 27.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJË OBJEKTI ARSIMOR NË BASHKINË VORË DHE CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 500, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi, në masën 92 452 637

(nëntëdhjetë e dy milionë e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të objektit arsimor, shkolla e mesme "Isa Boletini", Bashkia Vorë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 359, datë 5.6.2024

## PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 181, DATË 30.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUJË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/2 shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/3. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, në masën 1 079 695 259 (një miliard e shtatëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe u transferohet bashkive Tiranë dhe Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për Bashkinë Tiranë, në masën 711 979 470 (shtatëqind e njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) Për Bashkinë Durrës, në masën 367 715 789 (treqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1 e 2 dhe 2/1 të këtij vendimi ..." zëvendësohen me "... sipas dispozitave të këtij vendimi ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Tiranë e Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 360, datë 5.6.2024

## PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 491, DATË 21.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT TË QENDRAVE SHËNDETËSORE NË BASHKINË KURBIN DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.

97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 491, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2 Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 155 147 100 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind) lekë pa TVSH, që do të përballohet nga shpenzimet e buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) 48 933 660 (dyzet e tetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të qendrës shëndetësore në fshatin Gjorëm, Njësia Administrative Mamurras;

b) 24 803 600 (njëzet e katër milionë e tetëqind e tre mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të qendrës shëndetësore Sanxhak-Laç, Njësia Administrative Laç;

c) 61 126 160 (gjashtëdhjetë e një milionë e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të qendrës shëndetësore në qytetin e Mamurrasit, Njësia Administrative Mamurras;

ç) 5 065 200 (pesë milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të qendrës shëndetësore në qytetin e Laçit, Njësia Administrative Laç;

d) 15 218 480 (pesëmbëdhjetë milionë e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të qendrës shëndetësore në Fushë-Milot, Njësia Administrative Milot.";

b) Në pikën 3, fjalët " sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2.2 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 361, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 206, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË STACIONIT TË ZJARRFIKËSES DHE TË GODINËS SË BORDIT TË KULLIMIT, BASHKIA KAVAJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 206, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2 Bashkisë Kavajë, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i transferohet fondi, në masën 12 021 437 (dymbëdhjetë milionë e njëzet e një mijë e katërqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për rindërtimin e stacionit të zjarrfikëses, Bashkia Kavajë, në vlerën 456 768 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;

b) Për rindërtimin e godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, në vlerën 11 564 669 (njëmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 362, datë 5.6.2024**

## PËR KALIMIN TE BASHKIA TIRANË TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Tiranë të 229 (dyqind e njëzet e nëntë) apartamenteve, në 3 (tri) ndërtesa me njësi banimi (pallat), sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

LISTA E INVENTARIT TË OBJEKTEVE TË PËRFUNDUARA NË ZONËN “5 MAJ” (TË KOLAUDUARA)

| Nr. | Emërtimi i objektit | Vlera e objektit sipas kontratës (ndërtim + montim + projektim) | Vlera e situacionit përfundimtar (ndërtim + montim) | Vlera e studim projektimit | Vlera e Mbikëqyrjes së punimeve | Vlera e kolaudimit të punimeve | Vlera totale | Sipërfaqe totale ndërtimi ($m^2$) | Sipërfaqe banimi ap. ($m^2$) | Sipërfaqja e njësive të shërbimit | Sipërfaqja e katit -1 | Hapësirë e përbashkët (kat -1 + kat përdhe + kate banimi + kafaz ashensor + pandus + pasazh) | Ap. 1+1 | Ap. 2+1 | Ap. 3+1 | Total apartamente (nr.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Banesë kolektive, godina 15A (seksioni 1) | 573,665,006.00 | 562,682,984.80 | 10,975,603.00 | 5,640,000.00 | 228,250.00 | 579,526,837.80 | 12,357.00 | 6,221.50 | 1,143.90 | 2,989.50 | 2,002.10 | 11 | 31 | 15 | 57 |
| 2 | Banesë kolektive, godina 18 | 563,001,100.00 | 546,048,885.40 | 16,950,000.00 | 4,714,049.15 | 189,000.00 | 567,901,934.55 | 12,531.00 | 7,596.00 | 1,052.00 | 2,920.00 | 963.00 | 33 | 57 | 12 | 102 |
| 3 | Banesë kolektive, godina 12 (seksioni C) | 439,257,843.00 | 422,947,820.34 | 7,081,334.00 | 3,780,000.00 | 130,000.00 | 433,939,154.34 | 9,471.00 | 5,431.00 | 1,043.00 | 1,996.00 | 1,001.00 | 15 | 35 | 20 | 70 |
| **TOTAL** | | **1,575,923,949** | **1,531,679,691** | **35,006,937** | **14,134,049** | **547,250** | **1,581,367,927** | **34,359** | **19,249** | **3,239** | **7,906** | **3,966** | **59** | **123** | **47** | **229** |

**VENDIM**
**Nr. 363, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 279, DATË 12.5.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT SOCIAL-KULTUROR, PALLATI I KULTURËS, BASHKIA SHIJAK, DHE CAKTIMIN E BASHKISË SHIJAK SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/3, të vendimit nr. 279, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/4, me këtë përmbajtje:

"2/4. Bashkisë Shijak, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, nga fondet e rindërtimit, miratuar për vitin 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 37 496 534 (tridhjetë e shtatë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 364, datë 5.6.2024**

**PËR KALIMIN TE BASHKIA TIRANË TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 9, të nenit 19, të pikës 5, të nenit 20, dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Tiranë të 682 (gjashtëqind e tetëdhjetë e dy) njësive individuale të banimit, sipas listave të inventarit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

| | BANESA INDIVIDUALE BASHKIA TIRANE | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Njësi administrative | Sipërfaqe për tipologji | | | Sipërfaqe totale (m²) | Nr. i banesave të realizuara | Nr. i banesave sipas tipologjive | | | Vlera totale Situacion përfundimtar | Vlera e mbikëqyrjes së punimeve | Vlera e kolaudimit të punimeve | Vlera totale |
| | | Tip (1+1) | Tip (2+1) | Tip(3+1) | | | Tip (1+1) | Tip (2+1) | Tip (3+1) | | | | |
| | | | | | **44,896.5** | **506** | **98** | **193** | **215** | **1,362,110,424** | **17,681,407** | **4,202,253** | **1,383,994,083** |
| 1 | Farkë | 70 | 80 | 105.1 | 3,891.8 | 44 | 8 | 18 | 18 | 119,386,002 | 1,822,600 | 73,200 | 121,281,802 |
| 2 | Farkë | 70 | 80 | 105.1 | 370.2 | 4 | - | 2 | 2 | 11,000,742 | 173,000 | 28,110 | 11,201,852 |
| 3 | Farkë | 70 | 80 | 105.1 | 900.4 | 10 | - | 6 | 4 | 27,100,028 | 411,200 | 43,000 | 27,554,228 |
| 4 | Dajt, Shëngjegj Kashar, Pezë | 70 | 80 | 105.1 | 3,936.1 | 48 | 18 | 19 | 11 | 121,520,000 | 1,910,020 | 545,579 | 123,975,599 |
| 5 | Baldushk, Bërzhitë | 70 | 80 | 105.1 | 3,601.6 | 41 | 8 | 17 | 16 | 106,790,000 | 155,698 | 52,670 | 106,998,368 |
| 6 | Zallherr | 70 | 80 | 105.1 | 4,012.4 | 43 | 3 | 16 | 24 | 122,555,000 | 388,120 | 59,392 | 123,002,512 |
| 7 | Zallherr | 70 | 80 | 105.1 | 1,230.6 | 14 | 4 | 4 | 6 | 37,728,000 | 143,500 | 41,342 | 37,912,842 |
| 8 | Krrabë | 70 | 80 | 105.1 | 590.2 | 7 | 2 | 3 | 2 | 17,530,000 | 277,100 | 79,150 | 17,886,250 |
| 9 | Baldushk | 70 | 80 | 105.1 | 395.3 | 4 | - | 1 | 3 | 11,660,000 | 179,100 | 24,290 | 11,863,390 |
| 10 | Ndroq | 70 | 80 | 105.1 | 3,246.3 | 38 | 12 | 13 | 13 | 96,700,000 | 1,958,150 | 445,980 | 99,104,130 |
| 11 | Pezë Shëngjergj Dajt | 70 | 80 | 105.1 | 1,225.5 | 14 | 2 | 7 | 5 | 36,500,000 | 575,630 | 161,580 | 37,237,210 |
| 12 | Vaqarr | 70 | 80 | 105.1 | 1,520.8 | 17 | 4 | 5 | 8 | 46,415,944 | 312,218 | 42,250 | 46,770,412 |
| 13 | Kashar, Lagjja 13 | 70 | 80 | 105.1 | 545.3 | 6 | 1 | 2 | 3 | 16,633,884 | 254,860 | 28,870 | 16,917,614 |
| 14 | Krrabë | 70 | 80 | 105.1 | 70.0 | 1 | 1 | - | - | 2,100,000 | 33,270 | 10,280 | 2,143,550 |
| 15 | Baldushk | 70 | 80 | 105.1 | 1,340.6 | 15 | 1 | 8 | 6 | 39,900,000 | 597,722.6 | 170,270 | 40,667,993 |
| 16 | Ndroq | 70 | 80 | 105.1 | 2,015.9 | 23 | 5 | 9 | 9 | 60,000,000 | 1,353,800 | 265,870 | 61,619,670 |
| 17 | Pezë | 70 | 80 | 105.1 | 945.3 | 11 | 1 | 7 | 3 | 29,166,000 | 445,460 | 127,880 | 29,739,340 |
| 18 | Farkë | 70 | 80 | 105.1 | 815.7 | 8 | - | 1 | 7 | 24,685,000 | 372,420 | 33,500 | 25,090,920 |
| 19 | Kashar | 70 | 80 | 105.1 | 810.4 | 9 | 1 | 4 | 4 | 24,100,000 | 379,500 | 105,600 | 24,585,100 |
| 20 | Petrelë | 70 | 80 | 105.1 | 1,035.5 | 12 | 5 | 2 | 5 | 31,270,824 | 484,840 | 138,990 | 31,894,654 |
| 21 | Zallherr | 70 | 80 | 105.1 | 5,953.4 | 65 | 10 | 21 | 34 | 181,945,000 | 2,586,425 | 789,300 | 185,320,725 |
| 22 | Farkë | 70 | 80 | 105.1 | 3,861.6 | 44 | 6 | 22 | 16 | 118,672,000 | 1,723,174.6 | 598,550 | 120,993,725 |
| 23 | Zallherr | 70 | 80 | 105.1 | 2,581.6 | 28 | 6 | 6 | 16 | 78,752,000 | 1,143,598.6 | 336,600 | 80,232,199 |

| BANESA INDIVIDUALE BRENDA DHE JASHTË ZONAVE TË REJA SIPAS PDyV-së | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Njësi administrative | Sipërfaqe për tipologji | | | Sipërfaqe totale (m²) | Nr. i banesave të realizuara | Nr. i banesave sipas tipologjive | | | Vlera totale, situacion përfundimtar | Vlera e mbikëqyrjes së punimeve | Vlera e kolaudimit të punimeve | Vlerë totale |
| | | Tip (1+1) | Tip (2+1) | Tip (3+1) | | | Tip (1+1) | Tip (2+1) | Tip (3+1) | | | | |
| | | | | | **19,924** | **176** | **41** | **70** | **65** | **490,954,819** | **5,848,828** | **1,924,710** | **498,728,357** |
| 1 | Baldushk | 70 | 80 | 105.1 | 2,506.3 | 28 | 6 | 9 | 13 | 73,867,617 | 215,724.66 | 277,550 | 74,360,891.7 |
| 2 | Zall Herr | 70 | 80 | 105.1 | 4,131.6 | 49 | 19 | 14 | 16 | 127,013,000 | 1,864,400 | 487,000 | 129,364,400 |
| 3 | Ndroq | 70 | 80 | 105.1 | 6,643.2 | 74 | 8 | 34 | 32 | 203,791,985 | 2,860,729.54 | 878,960 | 207,531,674.5 |
| 4 | Pezë | 70 | 80 | 105.1 | 6,643.2 | 25 | 8 | 13 | 4 | 86,282,217 | 907,973.9 | 281,200 | 87,471,390.9 |

**VENDIM**
**Nr. 365, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 166, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË KAMZË DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 166, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/2 shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/3. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 122 897 923 (njëqind e njëzet e dy milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamzë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.".

b) Në pikën 3, fjalët "... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ..." zëvendësohen me "... sipas pikave 1, 2, 2/1, 2/2 dhe 2/3 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 366, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 645, DATË 3.8.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) DHE NDËRTESAVE PUBLIKE, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË NJËSITË ADMINISTRATIVE 4 E 8, ZONA '5 MAJI', DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE 6, ZONA 'KOMBINAT', BASHKIA TIRANË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.3, të vendimit nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.4, me këtë përmbajtje:

"2.4 Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, në masën 2 430 930 665 (dy miliardë e katërqind e tridhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona "5 Maji", dhe Njësinë Administrative 6, zona "Kombinat", në Bashkinë Tiranë, i cili

përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 367, datë 5.6.2024

## PËR KALIMIN NË PRONËSI TE BASHKIA TIRANË TË OBJEKTEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, e të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi te Bashkia Tiranë të 21 (njëzet e një) objekteve publike, sipas listave të inventarit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

TË DHËNAT E PËRMBLEDHURA PËR OBJEKTET ARSIMORE DHE OBJEKTET PUBLIKE/BASHKIA TIRANË

| Nr. | Qarku | Bashkia | Njësia Administrative | Niveli | Emërtimi i objektit | Tipologjia e Ndërhyrjes | Financimi i Ndërtimit | Sipërfaqe totale ndërtimit (m²) | Vlera e projektidesë | Vlera e projektit të zbatimit dhe ndërtimit | Vlera e mbikëqyrësit | Vlera e kolaudimit | Vlera totale e objektit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Tiranë | Tiranë | 12 | 9-vjeçare | Shkolla "17 Shkurti, Qesarakë e Vjetër" (Klodian Tanushi) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 3,630.6 | 1,563,500 | 191,167,228.1 | 1,488,380 | 72,400 | 194,291,508.1 |
| 2 | Tiranë | Tiranë | Petrelë | 9-vjeçare | Kopshti "Gurre" | Ndërtim i ri | Rindërtim | 798 | 300,000 | 30,760,000 | 325,462 | 36,400 | 31,421,862.0 |
| 3 | Tiranë | Tiranë | Peze | 9-vjeçare | Shkolla e ciklit të Ulët "Pajan" | Ndërtim i ri | Rindërtim | 1,283.9 | 426,000 | 59,475,947 | 573,197 | 42,000 | 60,517,144.0 |
| 4 | Tiranë | Tiranë | 9 | Mesme | Shkolla "Sami Frashëri" | Ndërtim i ri | Rindërtim | 9,231.6 | 3,609,225 | 567,492,069 | 4,769,609 | 226,000 | 576,096,903.0 |
| 5 | Tiranë | Tiranë | 8 | 9-vjeçare | Shkolla në rrugën "Besim Daja" (Lek Gjiknuri) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 2,617 | | 139,199,208.8 | 1,400,000 | 62,000 | 140,661,208.8 |
| 6 | Tiranë | Tiranë | Zall-Herr | 9-vjeçare | Shkolla 9-vjeçare "Dritas" | Ndërtim i ri | Rindërtim | 3,168 | | 179,507,828.59 | 1,700,000 | 70,000 | 181,277,828.6 |
| 7 | Tiranë | Tiranë | 6 | Qendër komunitare | Qendra Sociale "Të qëndrojmë së bashku" | Ndërtim i ri | Rindërtim | 2,310 | 867,000 | 129,297,155 | 1,071,180 | 60,800 | 131,296,135.0 |
| 8 | Tiranë | Tiranë | Zall-Herr | Qendër komunitare | Godina e shërbimeve komunitare Zall-Herr | Ndërtim i ri | Rindërtim | 380 | | 26,261,521 | 320,000 | 32,000 | 26,613,521.0 |
| 9 | Tiranë | Tiranë | Ndroq | Kopsht çerdhe + q. shëndetësore | Kopsht, çerdhe dhe qendër shëndetësore – Ndroq | Ndërtim i ri | Rindërtim | 821 | | 45,365,201 | 514,000 | 38,000 | 45,917,200.9 |
| 10 | Tiranë | Tiranë | Vaqar | 9-vjeçare | Shkolla "Bedri Llagami" Vaqarr | Ndërtim i ri | Rindërtim | 4,900 | | 199,777,819 | 1,783,900 | 64,000 | 201,625,718.8 |
| | | | | | | | TOTAL | 29,140.1 | 6,765,725.0 | 1,568,303,977.18 | 13,945,728.0 | 703,600.0 | 1,589,719,030.18 |

TË DHËNAT E PËRMBLEDHURA PËR OBJEKTET ARSIMORE UNIVERSITARE (GODINA PËR STUDENTË)/BASHKIA TIRANË

| Nr. | Qarku | Bashkia | Njësia Administrative | Niveli | Emërtimi i objektit | Tipologjia e ndërhyrjes | Financimi i ndërtimit | Sipërfaqe totale ndërtimit (m²) | Vlera e projektidesë | Vlera e projektit të zbatimit dhe ndërtimit | Vlera e mbikëqyrësit | Vlera e kolaudimit | Vlera totale e objektit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Tiranë | Tiranë | 2 | Konvikte për studentë | Godina TIP në RSU 1 (18) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 6,742.08 | 600,000 | 305,684,201.64 | 2,802,970.00 | 119,000.00 | 309,206,171.64 |
| 2 | Tiranë | Tiranë | 4 | Konvikte për studentë | Godina TIP në RSU nr. 2 (nr. 3) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 3,452.4 | 840,000 | 193,393,036.00 | 1,496,585.00 | 67,450.00 | 195,797,071.00 |
| 3 | Tiranë | Tiranë | 4 | Konvikte për studentë | Godina TIP në RSU nr. 2 (nr. 4) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 3,452.4 | 840,000 | 195,093,514.00 | 1,870,000.00 | 68,500.00 | 197,872,014.00 |
| 4 | Tiranë | Tiranë | 11 | Konvikte për studentë | Godina TIP në RSU nr. 3 (nr. 1) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 5,605 | 251,250 | 305,946,612.00 | 2,569,108.00 | 105,500.00 | 308,872,470.00 |
| 5 | Tiranë | Tiranë | 11 | Konvikte për studentë | Godina TIP në RSU nr. 3 (nr. 2) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 6,290 | 251,250 | 305,996,828.60 | 2,750,842.00 | 120,000.00 | 309,118,920.60 |
| 6 | Tiranë | Tiranë | 11 | Konvikte për studentë | Godina TIP në RSU nr. 3 (nr. 4) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 6,290 | 251,250 | 306,626,622.50 | 2,830,000.00 | 119,200.00 | 309,827,072.50 |
| 7 | Tiranë | Tiranë | 11 | Konvikte për studentë | Godina TIP në RSU nr. 3 (nr. 5) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 6,290 | 251,250 | 305,798,306.50 | 2,823,193.32 | 105,000.00 | 308,977,749.82 |
| 8 | Tiranë | Tiranë | 11 | Konvikte për studentë | Godina TIP në RSU nr. 3 (nr. 6) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 5,605 | 251,250 | 306,667,236.90 | 2,720,000.00 | 106,000.00 | 309,744,486.90 |
| 9 | Tiranë | Tiranë | 11 | Konvikte për studentë | Godina TIP në RSU nr. 3 (nr. 7) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 6,290 | 251,250 | 305,615,961.98 | 2,766,260.00 | 119,000.00 | 308,752,471.98 |
| 10 | Tiranë | Tiranë | 11 | Konvikte për studentë | Godina TIP në RSU nr. 3 ( nr. 8) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 6,290 | 251,250 | 305,330,826.00 | 2,830,000.00 | 120,000.00 | 308,532,076.00 |
| 11 | Tiranë | Tiranë | 2 | Konvikte për studentë | Godina TIP në RSU 1 (15) | Ndërtim i ri | Rindërtim | 6,728 | 600,000 | 305,100,281.32 | 2,817,300.00 | 97,000.00 | 308,614,581.32 |
| | | | | | | | TOTAL | 63,035.07 | 4,638,750.0 | 3,141,253,427.44 | 28,276,258.32 | 1,146,650.0 | 3,175,315,085.76 |

**VENDIM**
**Nr. 368, datë 5.6.2024**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 749, DATË 9.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË GODINËS SË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT DHE CAKTIMIN E INSTITUTIT TË NDËRTIMIT SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 749, datë 9.12.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2024 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin buxhetor "Planifikim, menaxhim dhe administrim" 01110, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", shtohet fondi prej 7 536 493,92 (shtatë milionë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre presje nëntëdhjetë e dy) lekësh pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit, i cili nuk është përdorur, sipas pikës 2/1, të këtij vendimi.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Ndërtimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 369, datë 5.6.2024**

## PËR KALIMIN TE BASHKIA DURRËS TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Durrës të 63 (gjashtëdhjetë e tre) apartamenteve, në 2 (dy) ndërtesa me njësi banimi (pallat), sipas listave të inventarit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**Banesa kolektive, Njësia Administrative Durrës, Njësi Banimi Pallat nr. 14, Bulevardi "Dyrrah"**

| Nr. | Emërtimi i objektit | Tipologjia | Nr. apart. | Kati | Shkalla | Sip. neto (m²) | Sip. bruto (m²) | Sip. përbashkët (m²) | Sip. totale përfshirë sip. e përbashkët (m²) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pallati nr. 14** | | | | | | | | | |
| **Kati 1** | | | | | | **194.13** | **217.70** | **23.19** | **240.89** |
| 1 | Pallati nr. 14 | 2+1 | 1 | 1 | 1 | 74.30 | 82.84 | 8.84 | 91.68 |
| 2 | Pallati nr. 14 | 1+1 | 2 | 1 | 1 | 45.42 | 49.84 | 5.30 | 55.14 |
| 3 | Pallati nr. 14 | 2+1 | 3 | 1 | 1 | 74.41 | 85.02 | 9.05 | 94.07 |
| **Kati 2** | | | | | | **193.59** | **217.7** | **23.19** | **240.89** |
| 1 | Pallati nr. 14 | 2+1 | 4 | 2 | 1 | 73.76 | 82.84 | 8.84 | 91.68 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Pallati nr. 14 | 1+1 | 5 | 2 | 1 | 45.42 | 49.84 | 5.30 | 55.14 |
| 3 | Pallati nr. 14 | 2+1 | 6 | 2 | 1 | 74.41 | 85.02 | 9.05 | 94.07 |
| **Kati 3** | | | | | | **193.59** | **217.70** | **23.19** | **240.89** |
| 1 | Pallati nr. 14 | 2+1 | 7 | 3 | 1 | 73.76 | 82.84 | 8.84 | 91.68 |
| 2 | Pallati nr. 14 | 1+1 | 8 | 3 | 1 | 45.42 | 49.84 | 5.30 | 55.14 |
| 3 | Pallati nr. 14 | 2+1 | 9 | 3 | 1 | 74.41 | 85.02 | 9.05 | 94.07 |
| **Kati 4** | | | | | | **197.61** | **219.65** | **21.24** | **240.89** |
| 1 | Pallati nr. 14 | 3+1 | 10 | 4 | 1 | 99.15 | 109.86 | 10.62 | 120.48 |
| 2 | Pallati nr. 14 | 3+1 | 11 | 4 | 1 | 98.46 | 109.79 | 10.62 | 120.41 |
| **Kati 5** | | | | | | **197.61** | **219.65** | **21.24** | **240.89** |
| 1 | Pallati nr. 14 | 3+1 | 12 | 5 | 1 | 99.15 | 109.86 | 10.62 | 120.48 |
| 2 | Pallati nr. 14 | 3+1 | 13 | 5 | 1 | 98.46 | 109.79 | 10.62 | 120.41 |
| **Kati 6** | | | | | | **197.53** | **219.65** | **21.24** | **240.89** |
| 1 | Pallati nr. 14 | 3+1 | 14 | 6 | 1 | 99.20 | 109.86 | 10.62 | 120.48 |
| 2 | Pallati nr. 14 | 3+1 | 15 | 6 | 1 | 98.33 | 109.79 | 10.62 | 120.41 |
| | **Shuma e sipërfaqes** | | | **Leja e ndërtimit 1692,49 m²** | | **1,313.36** | **1,472.70** | **219.80** | **1,692.50** |

**Banesa kolektive, Njësia Administrative Durrës, Njësi Banimi Pallat nr. 1062, Rruga "26 Nëntori"**

| Nr. | Emërtimi i objektit | Tipologjia | Nr. apart. | Kati | Shkalla | Sip. neto (m²) | Sip. totale (m²) | Sip. përbashkët (m²) | Sip. totale përfshirë sip. e përbashkët (m²) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pallati nr. 1062, sipërfaqja totale** | | | | | | 3395 | 3844 | 616 | 4461 |
| **KATI 0** | | | | | | **393.26** | **452.66** | **104.34** | **557.00** |
| **Shkalla 1** | | | | | | | | | |
| 1 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 1 | 0 | 1 | 49.50 | 59.61 | 16.50 | 76.11 |
| 2 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 2 | 0 | 1 | 65.28 | 78.73 | 22.29 | 101.02 |
| 3 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 3 | 0 | 1 | 75.01 | 83.00 | 22.58 | 105.58 |
| **Shkalla 2** | | | | | | | | | |
| 4 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 1 | 0 | 2 | 72.1 | 79.48 | 14.76 | 94.24 |
| 5 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 2 | 0 | 2 | 69.27 | 79.28 | 14.73 | 94.01 |
| 6 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 3 | 0 | 2 | 62.10 | 72.56 | 13.48 | 86.04 |
| **Kati 1** | | | | | | **435.50** | **481.18** | **73.27** | **554.45** |
| **Shkalla 1** | | | | | | | | | |
| 7 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 4 | 1 | 1 | 65.01 | 78.39 | 12.00 | 90.39 |
| 8 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 5 | 1 | 1 | 66.21 | 79.50 | 12.16 | 91.66 |
| 9 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 6 | 1 | 1 | 76.5 | 83.31 | 12.75 | 96.06 |
| **Shkalla 2** | | | | | | | | | |
| 10 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 4 | 1 | 2 | 76.27 | 80.14 | 12.14 | 92.28 |
| 11 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 5 | 1 | 2 | 76.4 | 80.32 | 12.17 | 92.49 |
| 12 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 6 | 1 | 2 | 75.11 | 79.52 | 12.05 | 91.57 |
| **Kati 2** | | | | | | **421.82** | **481.00** | **73.74** | **554.74** |
| **Shkalla 1** | | | | | | | | | |
| 13 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 7 | 2 | 1 | 49.00 | 50.39 | 7.02 | 57.41 |
| 14 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 8 | 2 | 1 | 91.02 | 108.24 | 15.08 | 123.32 |
| 15 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 9 | 2 | 1 | 91.00 | 103.12 | 14.36 | 117.48 |
| **Shkalla 2** | | | | | | | | | |
| 16 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 7 | 2 | 2 | 49.95 | 59.93 | 10.12 | 70.05 |
| 17 | Pallati nr. 1062 | 3.1 | 8 | 2 | 2 | 91.35 | 108.50 | 18.58 | 127.08 |
| 18 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 9 | 2 | 2 | 49.5 | 50.82 | 8.58 | 59.40 |
| **Kati 3** | | | | | | **452.77** | **481.82** | **73.44** | **555.26** |
| **Shkalla 1** | | | | | | | | | |
| 19 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 10 | 3 | 1 | 75.01 | 78.46 | 11.89 | 90.35 |
| 20 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 11 | 3 | 1 | 75.4 | 79.50 | 12.04 | 91.54 |
| 21 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 12 | 3 | 1 | 76.62 | 83.66 | 12.67 | 96.33 |
| **Shkalla 2** | | | | | | | | | |
| 22 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 10 | 3 | 2 | 75.29 | 80.26 | 12.31 | 92.57 |
| 23 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 11 | 3 | 2 | 75.3 | 80.27 | 12.31 | 92.58 |
| 24 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 12 | 3 | 2 | 75.15 | 79.67 | 12.22 | 91.89 |
| **Kati 4** | | | | | | **430.93** | **486.89** | **72.46** | **559.35** |
| **Shkalla 1** | | | | | | | | | |
| 25 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 13 | 4 | 1 | 49.5 | 52.58 | 7.86 | 60.44 |
| 26 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 14 | 4 | 1 | 92.17 | 111.05 | 16.00 | 127.05 |
| 27 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 15 | 4 | 1 | 75 | 77.03 | 12.00 | 89.03 |
| **Shkalla 2** | | | | | | | | | |
| 28 | Pallati nr. 1062 | 2+1 | 13 | 4 | 2 | 77.25 | 86.40 | 10.01 | 96.41 |
| 29 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 14 | 4 | 2 | 91.41 | 108.73 | 18.09 | 126.82 |
| 30 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 15 | 4 | 2 | 45.6 | 51.10 | 8.50 | 59.60 |
| **Kati 5** | | | | | | **420.18** | **486.89** | **73.06** | **559.95** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shkalla 1** | | | | | | | | | |
| 31 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 16 | 5 | 1 | 49.5 | 52.58 | 7.19 | 59.77 |
| 32 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 17 | 5 | 1 | 92.17 | 111.05 | 15.17 | 126.22 |
| 33 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 18 | 5 | 1 | 91 | 103.23 | 14.10 | 117.33 |
| **Shkalla 2** | | | | | | | | | |
| 34 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 16 | 5 | 2 | 50.5 | 60.20 | 10.01 | 70.21 |
| 35 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 17 | 5 | 2 | 91.41 | 108.73 | 18.09 | 126.82 |
| 36 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 18 | 5 | 2 | 45.6 | 51.10 | 8.50 | 59.60 |
| **KATI 6** | | | | | | **420.18** | **486.89** | **73.06** | **559.95** |
| **Shkalla 1** | | | | | | | | | |
| 37 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 19 | 6 | 1 | 49.5 | 52.58 | 7.19 | 59.77 |
| 38 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 20 | 6 | 1 | 92.17 | 111.05 | 15.17 | 126.22 |
| 39 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 21 | 6 | 1 | 91 | 103.23 | 14.10 | 117.33 |
| **Shkalla 2** | | | | | | | | | |
| 40 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 19 | 6 | 2 | 50.5 | 60.20 | 10.01 | 70.21 |
| 41 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 20 | 6 | 2 | 91.41 | 108.73 | 18.09 | 126.82 |
| 42 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 21 | 6 | 2 | 45.6 | 51.10 | 8.50 | 59.60 |
| **Kati 7** | | | | | | **420.18** | **486.89** | **73.06** | **559.95** |
| **Shkalla 1** | | | | | | | | | |
| 43 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 22 | 7 | 1 | 49.5 | 52.58 | 7.19 | 59.77 |
| 44 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 23 | 7 | 1 | 92.17 | 111.05 | 15.17 | 126.22 |
| 45 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 24 | 7 | 1 | 91 | 103.23 | 14.10 | 117.33 |
| **Shkalla 2** | | | | | | | | | |
| 46 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 22 | 7 | 2 | 50.5 | 60.20 | 10.01 | 70.21 |
| 47 | Pallati nr. 1062 | 3+1 | 23 | 7 | 2 | 91.41 | 108.73 | 18.09 | 126.82 |
| 48 | Pallati nr. 1062 | 1+1 | 24 | 7 | 2 | 45.6 | 51.10 | 8.50 | 59.60 |

## VENDIM
## Nr. 370, datë 5.6.2024

## PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, dhe 25, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718 datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat *ISIL* (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*", shtohen individët e renditur në shkronjën "a", sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave *ISIL* (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-së

("LISTA E OKB-së")

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT *ISIL* (*Da'esh*) DHE *AL-QAIDA*

**a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat *ISIL* (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*":**

1. *Abdikadir; Mohamed; Abdikadir*
2. *Mohamed; Mohamud; Mire*
3. *Mohamed; Omar; Mohamed*

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personat, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

**VENDIM**
**Nr. 371, datë 5.6.2024**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Në pikën 10, të kreut I, pas fjalëve "... (CFSP) 2023/2498 ...." shtohen "... (CFSP) 2024/1339 ...".

Në aneksin 10, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2024/1339, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

Gazeta Zyrtare
e Bashkimit Evropian

AL
seritë L

2024/1339 14.5.2024

**VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2024/1339**

**i datës 13 maj 2024**

**mbi ndryshimin e Vendimit (CFSP) 2017/2074 në lidhje me masat kufizuese në funksion të situatës në Venezuelë**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Punë të Jashtme dhe të Sigurisë,

Ndërsa:

(1) Më 13 nëntor 2017, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2017/2074 ([1]).

(2) Më 10 nëntor 2023, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2023/2498 ([2]) për rinovimin e masave kufizuese të përcaktuara në Vendimin (CFSP) 2017/2074 deri më 14 maj 2024.

(3) Në bazë të një rishikimi të Vendimit (CFSP) 2017/2074, dhe duke marrë parasysh krizën e vazhdueshme politike, ekonomike, sociale dhe humanitare në Venezuelë, si dhe veprimet e vazhdueshme që minojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut , në mungesë të progresit konkret, të verifikueshëm dhe të qëndrueshëm të situatës në Venezuelë, dhe me qëllim forcimin e përpjekjeve të Venezuelës që synojnë ruajtjen e rrugës zgjedhore dhe zgjerimin e hapësirës demokratike në atë vend, Këshilli konsideron se masat kufizuese të përcaktuara në atë Vendim duhet të rinovohet deri më 10 janar 2025.

(4) Me synimin për të promovuar organizimin e zgjedhjeve gjithëpërfshirëse, të besueshme dhe konkurruese në Venezuelë, në përputhje me marrëveshjen politike të udhëhequr nga Venezuela e 17 tetorit 2023 në Barbados, dhe me qëllim mbështetjen e përpjekjeve të Venezuelës që synojnë ruajtjen e rrugës zgjedhore dhe duke zgjeruar hapësirën demokratike në vend, kufizimet e udhëtimit të aplikuara për katër persona fizikë të përfshirë në listën e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve të përcaktuara në Aneksin I të Vendimit (CFSP) 2017/2074 duhet të pezullohen.

(5) Për më tepër, shënimet për gjashtë persona fizikë në Aneksin I të Vendimit (CFSP) 2017/2074 duhet të përditësohen.

(6) Vendimi (CFSP) 2017/2074 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

*Neni 1*

(1) Vendimi (CFSP) 2017/2074 ndryshohet si më poshtë:

(1) në nenin 6, futet paragrafi në vijim:

'1a. Paragrafi 1 nuk zbatohet për personat fizikë të identifikuar me yll në aneks.'

(2) në nenin 13 paragrafi i parë zëvendësohet si vijon:

"Ky vendim do të zbatohet deri më 10 janar 2025.";

(3) Aneksi I është ndryshuar në përputhje me aneksin e këtij vendimi.

(1) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2017/2074 i datës 13 nëntor 2017 në lidhje me masat kufizuese në funksion të situatës në Venezuelë (OJ L 295, 14.11.2017, f. 60).
(2) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2023/2498 i datës 10 nëntor 2023 që ndryshon Vendimin (CFSP) 2017/2074 në lidhje me masat kufizuese në funksion të situatës në Venezuelë (OJ L, 2023/2498, 13.11.2023, ELI: http://www. /data.europa.eu/eli/dec/2023/2498/oj).

*Neni 2*

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, 13 maj 2024.

Për Këshillin

*Presidenti*

B. DALLE

*ANEKS*

Aneksi I i Vendimit (CFSP) 2017/2074 ndryshohet si më poshtë:

(1) në "Listën e personave, enteve dhe organeve fizike dhe juridike të përmendura në nenet 6(1) dhe 7(1)", shënimet 6, 9, 17, 18, 21, 23, 29, 48, 49 dhe 50 zëvendësohen me shënimet e mëposhtme:

| | Emri | Informacion identifikues | Arsyet | Data e listimit |
|---|---|---|---|---|
| '6. | Tarek William SAAB HALABI | Datëlindja: 10 shtator 1963<br>Vendlindja: El Tigre, shteti Anzoátegui, Venezuelë<br>Gjinia: mashkull | President i Këshillit Moral Republikan që nga dhjetori 2023. Prokuror i Përgjithshëm i Venezuelës i emëruar nga Asambleja Kushtetuese. Në ato role, dhe në rolet e mëparshme si Ombudsman dhe President i Këshillit Republikan Moral, ai ka minuar demokracinë dhe sundimin e ligjit në Venezuelë duke mbështetur publikisht veprimet kundër kundërshtarëve të qeverisë së Venezuelës dhe tërheqjen e kompetencave nga Asambleja Kombëtare. | 22.1.2018 |
| 9. | Sergio José RIVERO MARCANO | Datëlindja: 8 nëntor 1964<br>Gjinia: mashkull | Inspektor i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Kombëtare Bolivariane (FANB), Komandant i Përgjithshëm i Gardës Kombëtare Bolivariane deri më 16 janar 2018, i vendosur në "rezervë aktive" në korrik 2023. I përfshirë në shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Venezuelë dhe përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera nga Garda Kombëtare Bolivariane nën komandën e tij, duke përfshirë përdorimin e tepruar të forcës dhe ndalimin dhe abuzimin arbitrar të shoqërisë civile dhe anëtarëve të opozitës. Veprimet dhe politikat e tij si Komandant i Përgjithshëm i Gardës Kombëtare Bolivariane, duke përfshirë Gardën Kombëtare Bolivariane që sulmon anëtarët e Asamblesë Kombëtare të zgjedhur në mënyrë demokratike dhe frikësimin e gazetarëve që raportojnë për zgjedhjet e falsifikuara për Asamblenë Kushtetuese të paligjshme, kanë minuar demokracinë dhe sundimin e ligjit në Venezuelë. . | 25.6.2018 |

| | Emri | Informacion identifikues | Arsyet | Data e listimit |
|---|---|---|---|---|
| 17. | Socorro Elizabeth HERNÁNDEZ* | Datëlindja: 11 mars 1952<br>Gjinia: femër | Anëtare (Rektore) e Këshillit Kombëtar Zgjedhor (KNE) deri më 12 Qershor 2020 dhe anëtare e Bordit Kombëtar Zgjedhor (JNE). Përgjegjëse për aktivitetet e CNE që kanë minuar demokracinë në Venezuelë, duke përfshirë lehtësimin e krijimit të Asamblesë Kushtetuese të paligjshme dhe manipulimin e procesit zgjedhor në lidhje me anulimin e zgjedhjeve presidenciale në 2016, shtyrjen e zgjedhjeve guvernatoriale në 2016 dhe zhvendosjen e qendrave të votimit në një njoftim të shkurtër përpara zgjedhjeve guvernatoriale në 2017. | 25.6.2018 |
| 18. | Xavier Antonio MORENO REYES* | Gjinia: mashkull | Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Kombëtar Zgjedhor (CNE) nga viti 2009 deri në qershor 2020. Në këtë rol, Moreno Reyes lehtësoi, legjitimoi dhe u dha besueshmëri vendimeve të CNE, pasi Sekretari i Përgjithshëm i CNE ka një rol në përcaktimin e agjendës dhe formalizimin e vendimeve. Moreno Reyes mbeti Sekretar i Përgjithshëm i CNE-së ndërkohë që demokracia u minua rëndë dhe roli i pavarur i CNE-së brenda procesit zgjedhor u komprometua. Prandaj, ai është përgjegjës për minimin e demokracisë në Venezuelë, duke përfshirë lehtësimin e krijimit të Asamblesë Kushtetuese të paligjshme dhe manipulimin e procesit zgjedhor. | 25.6.2018 |
| 21. | Carlos Alberto CALDERÓN CHIRINOS | Datëlindja: 3 korrik 1970<br>Numri personal: V-10352300<br>Gjinia: mashkull | Zyrtar me komandën elitare të Policisë Kombëtare të Venezuelës (PNB/FAES). Emërohet Zëvendës Drejtor i Drejtorisë së Veprimeve Strategjike dhe Taktike (DAET) të PNB-së në vitin 2023. Ish-zyrtar i lartë (i referuar si Komisioner i Përgjithshëm, Drejtor i El Helicoide dhe Drejtor i Hetimeve Strategjike) në Shërbimin Informativ Kombëtar Bolivarian (SEBIN). Zyrtarë të Drejtorisë për Hetime Strategjike nën mbikëqyrjen e tij kanë kryer ndalime të paligjshme, akte torture dhe keqtrajtime të tjera, si dhe dhunë seksuale dhe gjinore. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë torturën, përdorimin e forcës së tepruar dhe keqtrajtimin e të burgosurve në objektet e SEBIN. Në veçanti, ai ka marrë pjesë dhe është përgjegjës për aktet e torturës dhe trajtimin mizor, çnjerëzor dhe poshtërues të të burgosurve në El Helicoide, një burg SEBIN. | 27.9.2019 |

| | Emri | Informacion identifikues | Arsyet | Data e listimit |
|---|---|---|---|---|
| 23. | Rafael Antonio FRANCO QUINTERO | Datëlindja: 14 tetor 1973<br>Numri personal: V-11311672<br>Gjinia: mashkull | Gjeneral i Divizionit të Ushtrisë Kombëtare Bolivariane i Venezuelës (FANB). Agjent në Shërbimin Informativ Kombëtar Bolivarian (SEBIN). Shef i Sigurisë në Aeroportin Ndërkombëtar Maiquetía që nga gushti 2019. Drejtor i Drejtorisë së Posaçme të Hetimeve Kriminale dhe Kriminalistike (DEIPC) në Drejtorinë e Përgjithshme të Kundërzbulimit Ushtarak (Dirección General de Contrainteligencia Militar (DGCIM)) nga nëntori 2016 deri në nëntor 2018. Përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë torturën, përdorimin e forcës së tepruar dhe keqtrajtimin e të burgosurve në ambientet e DGCIM nga anëtarë të DGCIM nën komandën e tij, veçanërisht në qendrën e paraburgimit Boleita. Zyrtarët nën autoritetin e tij u implikuan edhe në dhunën seksuale ndaj të arrestuarve. Gjithashtu përgjegjës për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike nga anëtarët e DGCIM nën komandën e tij. I implikuar me vdekjen e kapitenit Acosta Arévalo. | 27.9.2019 |
| 29. | Elvis Eduardo HIDROBO AMOROSO* | Datëlindja: 4 gusht 1963<br>Vendlindja: Karakas, Qarku i kryeqytetit, Venezuelë<br>Numri personal: V-7659695<br>Gjinia: mashkull | President i Komisionit Kombëtar Zgjedhor të Venezuelës që nga 24 gushti 2023. Ish Kontrollor i Përgjithshëm (ndërmjet 23 tetorit 2018 dhe gushtit 2023), dhe ish-Zëvendëspresident i Parë dhe i Dytë i Asamblesë Kushtetuese Kombëtare të pa njohur (ANC). Veprimet e tij kanë minuar demokracinë dhe sundimin e ligjit në Venezuelë, duke përfshirë ndalimin e anëtarëve të opozitës nga mbajtja e posteve publike për 15 vjet dhe udhëheqjen e ANC-së së pa njohur, duke nënshkruar "ligjin kundër urrejtjes", duke justifikuar largimin e guvernatorit të opozitës të zgjedhur ligjërisht dhe ndalimin e Juan Guaidó-s për të kandiduar për ndonjë post publik. | 29.6.2020 |

| | Emri | Informacion identifikues | Arsyet | Data e listimit |
|---|---|---|---|---|
| 48. | Leonardo Enrique MORALES POLEO* | Gjinia: mashkull | Ish nënkryetar i Këshillit Kombëtar Zgjedhor (Consejo Nacional Electoral (CNE)) dhe President i Komisionit të Pjesëmarrjes Politike dhe Financimit (gusht 2020–maj 2021). Leonardo Enrique Morales Poleo u emërua Zëvendës President i CNE dhe President i Komisionit të Pjesëmarrjes Politike dhe Financimit më 7 gusht 2020 nga Gjykata e Lartë (Tribunal Supremo de Justicia (TSJ)) megjithëse kjo prerogativë i përket Asamblesë Kombëtare. Për më tepër, pak para emërimit të tij ai shërbeu në Partinë Përparimtare të Avancuar (Avanzada progressista). Si anëtar (rektor) dhe nënkryetar i CNE-së, ka marrë pjesë plotësisht në procesin e vendimmarrjes së CNE-së. Ai mbështeti dhe lehtësoi mbikëqyrjen e procesit zgjedhor që çoi në zgjedhjet jodemokratike të Asamblesë Kombëtare më 6 dhjetor 2020. Prandaj, veprimet e tij kanë minuar më tej demokracinë dhe sundimin e ligjit në Venezuelë. Leonardo Enrique Morales Poleo pranoi të emërohej në CNE dhe mbeti në pozicionin e tij si Zëvendës President i CNE ndërsa demokracia ishte minuar rëndë në Venezuelë. | 22.2.2021 |
| 49. | Tania D'AMELIO CARDIET | Datëlindja: 5 December 1971<br>Vendlindja: Itali<br>Kombësia: Venezueliane<br>Numri personal : V-11691429<br>Gjinia: femër | Nënkryetare e dytë e Gjykatës së Lartë (Tribunal Supremo de Justicia (TSJ)) dhe Kryetare e Dhomës Kushtetuese të asaj gjykate, që nga janari 2024. Ish-anëtare (rektore) e Këshillit Kombëtar Zgjedhor (Consejo Nacional Electoral (CNE)) për periudhën 2016-2023. Ish Anëtare (rektore) e CNE për periudhën 2010-2016. Tania d'Amelio Cardiet, si rektore e CNE që nga viti 2010, kontribuoi drejtpërdrejt me veprimtarinë e saj në funksionet e saj në minimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Venezuelë, duke përfshirë përgatitjen e zgjedhjeve jodemokratike të Asamblesë Kombëtare të vitit 2020, duke marrë pjesë në ndryshimin e datës 30 qershor 2020 të normave zgjedhore për ato zgjedhje dhe pjesëmarrjen në organizimin dhe zbatimin e zgjedhjeve presidenciale 2018. Për më tepër, Tania d'Amelio Cardiet pranoi emërimin e saj në 2016 në CNE nga Gjykata e Lartë, megjithëse kjo prerogativë i përket Asamblesë Kombëtare. | 22.2.2021 |

| | Emri | Informacion identifikues | Arsyet | Data e listimit |
|---|---|---|---|---|
| 50. | José Miguel DOMÍNGUEZ RAMÍREZ | Datëlindja: 17 tetor 1979<br>Numri personal: V-14444352<br>Gjinia: mashkull | Drejtor i Drejtorisë së Veprimeve Strategjike dhe Taktike (DAET) që nga korriku 2022 dhe Ndihmësdrejtor i Policisë Kombëtare Bolivariane (PNB) që nga korriku 2023. Ish-drejtor i Forcave të Veprimit Special (Fuerzas de Acciones Especiales (FAES)). Ish-kryekomisioneri i FAES në shtetin Táchira. Për më tepër, José Miguel Domínguez Ramírez ishte Drejtor i Operacioneve të FAES, të cilat i përkasin Policisë Kombëtare Bolivariane të Venezuelës. Përgjegjës për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Venezuelë të kryera nga zyrtarët e FAES nën autoritetin e tij. FAES njihet për vrasjet jashtëgjyqësore dhe rolin e tyre të dhunshëm në shtypjen e disidentëve nga kundërshtarët politikë të Maduros, opozita dhe protestuesit, prandaj Komisionerja e Lartë e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Michelle Bachelet, ka kërkuar shpërbërjen e FAES. Për më tepër, më parë, Domínguez Ramírez ishte një anëtar i ekipit të sigurisë venezueliane që hapi zjarr ndaj protestuesve studentorë të paarmatosur më 12 shkurt 2014, duke rezultuar në vdekjen e të paktën një prej studentëve, Bassil Da Costa. | 22.2.2021'. |

(2) pas tabelës shtohet fjalia e mëposhtme:

" Neni 6(1) nuk zbatohet për shënimet e identifikuara me një asteriks.'.

Official Journal of the European Union
EN
L series
2024/1339 14.5.2024

**COUNCIL DECISION (CFSP) 2024/1339**

**of 13 May 2024**

**amending Decision (CFSP) 2017/2074 concerning restrictive measures in view of the situation in Venezuela**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 13 November 2017, the Council adopted Decision (CFSP) 2017/2074 [1].

(2) On 10 November 2023, the Council adopted Decision (CFSP) 2023/2498 [2] renewing the restrictive measures set out in Decision (CFSP) 2017/2074 until 14 May 2024.

(3) On the basis of a review of Decision (CFSP) 2017/2074, and considering the ongoing political, economic, social and humanitarian crisis in Venezuela, as well as persistent actions undermining democracy, the rule of law and respect for human rights, in the absence of concrete, verifiable and sustainable progress in the situation in Venezuela, and in order to strengthen efforts by Venezuela aimed at preserving the electoral path and at enlarging the democratic space in that country, the Council considers that the restrictive measures set out in that Decision should be renewed until 10 January 2025.

(4) With a view to promoting the organisation of inclusive, credible and competitive elections in Venezuela, in line with the Venezuelan-led political agreement of 17 October 2023 in Barbados, and in order to support efforts by Venezuela aimed at preserving the electoral path and enlarging the democratic space in the country, the travel restrictions applied to four natural persons included in the list of natural and legal persons, entities and bodies set out in Annex I to Decision (CFSP) 2017/2074 should be suspended.

(5) Furthermore, the entries for six natural persons in Annex I to Decision (CFSP) 2017/2074 should be updated.

(6) Decision (CFSP) 2017/2074 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

*Article 1*

Decision (CFSP) 2017/2074 is amended as follows:

(1) in Article 6, the following paragraph is inserted:

‘1a. Paragraph 1 shall not apply to the natural persons identified with an asterisk in the Annex.’

(2) in Article 13, the first paragraph is replaced by the following:

‘This decision shall apply until 10 January 2025.’;

(3) Annex I is amended in accordance with the Annex to this Decision.

(1) Council Decision (CFSP) 2017/2074 of 13 November 2017 concerning restrictive measures in view of the situation in Venezuela (OJ L 295, 14.11.2017, p. 60).
(2) Council Decision (CFSP) 2023/2498 of 10 November 2023 amending Decision (CFSP) 2017/2074 concerning restrictive measures in view of the situation in Venezuela (OJ L, 2023/2498, 13.11.2023, ELI: http://data.europa.eu/eli/dec/2023/2498/oj).

*Article 2*

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 13 May 2024.

*For the Council*

*The President*

B. DALLE

ANNEX

Annex I to Decision (CFSP) 2017/2074 is amended as follows:

(1) in the 'List of natural and legal persons, entities and bodies referred to in Articles 6(1) and 7(1)', entries 6, 9, 17, 18, 21, 23, 29, 48, 49 and 50 are replaced by the following entries:

| | Name | Identifying information | Reasons | Date of listing |
|---|---|---|---|---|
| '6. | Tarek William SAAB HALABI | Date of birth: 10 September 1963<br>Place of birth: El Tigre, Anzoátegui state, Venezuela<br>Gender: male | President of the Republican Moral Council since December 2023. Venezuelan Attorney General appointed by the Constituent Assembly. In those roles, and in previous roles as Ombudsman and President of the Republican Moral Council, he has undermined democracy and the rule of law in Venezuela by publicly supporting actions against opponents of the government of Venezuela and the withdrawal of competences from the National Assembly. | 22.1.2018 |
| 9. | Sergio José RIVERO MARCANO | Date of birth: 8 November 1964<br>Gender: male | Inspector General of the Bolivarian National Armed Forces (FANB), General Commander of the Bolivarian National Guard until 16 January 2018, placed in "active reserve" in July 2023. Involved in the repression of civil society and democratic opposition in Venezuela, and responsible for serious human rights violations committed by the Bolivarian National Guard under his command, including the excessive use of force, and the arbitrary detention and abuse of civil society and opposition members. His actions and policies as General Commander of the Bolivarian National Guard, including the Bolivarian National Guard assaulting members of the democratically elected National Assembly and intimidating journalists reporting on the fraudulent elections for the illegitimate Constituent Assembly, have undermined democracy and the rule of law in Venezuela. | 25.6.2018 |

| | Name | Identifying information | Reasons | Date of listing |
|---|---|---|---|---|
| 17. | Socorro Elizabeth HERNÁNDEZ* | Date of birth: 11 March 1952<br>Gender: female | Member (Rector) of the National Electoral Council (CNE) until 12 June 2020 and member of the National Electoral Board (JNE). Responsible for the CNE's activities which have undermined democracy in Venezuela, including facilitating the establishment of the illegitimate Constituent Assembly and manipulation of the electoral process in relation to a cancelled presidential recall election in 2016, postponement of gubernatorial elections in 2016, and the relocation of polling stations at short notice before gubernatorial elections in 2017. | 25.6.2018 |
| 18. | Xavier Antonio MORENO REYES* | Gender: male | Secretary-General of the National Electoral Council (CNE) from 2009 until June 2020. In that role, Moreno Reyes facilitated, legitimised and gave credibility to CNE decisions, since the Secretary-General of the CNE has a role in agenda-setting and formalising decisions. Moreno Reyes remained Secretary-General of CNE while democracy was severely undermined and the independent role of the CNE within the electoral process was compromised. He is therefore responsible for undermining democracy in Venezuela, including facilitating the establishment of the illegitimate Constituent Assembly and the manipulation of the electoral process. | 25.6.2018 |
| 21. | Carlos Alberto CALDERÓN CHIRINOS | Date of Birth: 3 July 1970<br>ID number: V-10352300<br>Gender: male | Official with the elite command of the Venezuelan National Police (PNB/FAES). Appointed Deputy Director of the Directorate of Strategic and Tactical Actions (DAET) of the PNB in 2023. Former senior office holder (referred to as General Commissioner, Director of El Helicoide and Director of Strategic Investigations) in the Bolivarian National Intelligence Service (SEBIN). Officials of the Directorate for Strategic Investigations under his supervision have committed illegal detentions, acts of torture and other ill-treatment, and sexual and gender-based violence. Responsible for serious human rights violations, including torture, the use of excessive force and the mistreatment of detainees in SEBIN facilities. In particular, he has participated in and is responsible for acts of torture and the cruel, inhuman and degrading treatment of detainees at El Helicoide, a SEBIN prison. | 27.9.2019 |

| | Name | Identifying information | Reasons | Date of listing |
|---|---|---|---|---|
| 23. | Rafael Antonio FRANCO QUINTERO | Date of birth: 14 October 1973<br>ID number: V-11311672<br>Gender: male | Division General of the Venezuelan Bolivarian National Army (FANB). Agent in the Bolivarian National Intelligence Service (SEBIN). Head of Security at Maiquetía International Airport since August 2019. Director of the Special Directorate of Criminal and Criminalistics Investigations (DEIPC) at the Directorate-General of Military Counter-Intelligence (Dirección General de Contrainteligencia Militar (DGCIM)) between November 2016 and November 2018. Responsible for serious human rights violations, including torture, the use of excessive force and the ill-treatment of detainees in DGCIM facilities by members of the DGCIM under his command, notably at the Boleita detention centre. Officials under his authority were also implicated in sexual violence against detainees. Also responsible for the repression of civil society and democratic opposition by members of the DGCIM under his command. Linked to the death of Captain Acosta Arévalo. | 27.9.2019 |
| 29. | Elvis Eduardo HIDROBO AMOROSO" | Date of birth: 4 August 1963<br>Place of birth: Caracas, Distrito Capital, Venezuela<br>ID number: V-7659695<br>Gender: male | President of the National Electoral Commission of Venezuela since 24 August 2023. Former Comptroller General (between 23 October 2018 and August 2023), and former First and Second Vice-President of the non-recognised National Constituent Assembly (ANC). His actions have undermined democracy and the rule of law in Venezuela, including by banning opposition members from holding public office for 15 years and leading the non-recognised ANC, signing the "law against hatred", justifying the removal of a legally-elected opposition governor and banning Juan Guaidó from running for any public office. | 29.6.2020 |

| | Name | Identifying information | Reasons | Date of listing |
|---|---|---|---|---|
| 48. | Leonardo Enrique MORALES POLEO* | Gender: male | Former Vice-President of the National Electoral Council (Consejo Nacional Electoral (CNE)) and President of the Political Participation and Financing Commission (August 2020–May 2021). Leonardo Enrique Morales Poleo was appointed Vice-President of the CNE and President of the Political Participation and Financing Commission on 7 August 2020 by the Supreme Court (Tribunal Supremo de Justicia (TSJ)) although this prerogative belongs to the National Assembly. Moreover, just prior to his appointment he served in the Advanced Progressive Party (Avanzada progresista). As member (rector) and Vice-President of the CNE, he fully took part in the decision-making process of the CNE. He supported and facilitated the supervision of the electoral process that led to the non-democratic elections of the National Assembly on 6 December 2020. His actions have therefore further undermined democracy and the rule of law in Venezuela. Leonardo Enrique Morales Poleo accepted to be appointed to the CNE and remained in his position as Vice-President of the CNE while democracy was severely undermined in Venezuela. | 22.2.2021 |
| 49. | Tania D'AMELIO CARDIET | Date of birth: 5 December 1971<br>Place of birth: Italy<br>Nationality: Venezuelan<br>ID-number: V-11691429<br>Gender: female | Second Vice-President of the Supreme Court (Tribunal Supremo de Justicia (TSJ)), and President of the Constitutional Chamber of that court, since January 2024. Former member (rector) of the National Electoral Council (Consejo Nacional Electoral (CNE)) for the period 2016-2023. Former Member (rector) of the CNE for the period 2010-2016. Tania d'Amelio Cardiet, as rector of the CNE since 2010, contributed directly by her activity in her functions to the undermining of democracy and the rule of law in Venezuela, including by preparing the non-democratic 2020 National Assembly elections, participating in the change of 30 June 2020 to the electoral norms for those elections, and participating in the organisation and execution of the 2018 presidential elections. Moreover, Tania d'Amelio Cardiet accepted her 2016 appointment at the CNE by the Supreme Court, although this prerogative belongs to the National Assembly. | 22.2.2021 |

| | Name | Identifying information | Reasons | Date of listing |
|---|---|---|---|---|
| 50. | José Miguel DOMÍNGUEZ RAMÍREZ | Date of birth: 17 October 1979<br>ID-number: V-14444352<br>Gender: male | Director of the Directorate of Strategic and Tactical Actions (DAET) since July 2022 and Assistant Director of the Bolivarian National Police (PNB) since July 2023. Former Director of the Special Action Forces (Fuerzas de Acciones Especiales (FAES)). Former Chief Commissioner of the FAES in Táchira State. Additionally, José Miguel Domínguez Ramírez was the Director of Operations of the FAES, which fall within Venezuela's Bolivarian National Police. Responsible for serious human rights violations and repressing of civil society and democratic opposition in Venezuela committed by FAES officials under his authority. The FAES are known for extrajudicial killings and their violent role in suppressing dissent from Maduro's political opponents, the opposition, and protesters, which is why the United Nations High Commissioner for Human Rights, Michelle Bachelet, has demanded the dissolution of the FAES. Moreover, previously, Domínguez Ramírez was a member of the Venezuelan security team that opened fire on unarmed student protestors on 12 February 2014, resulting in the death of at least one of the students, Bassil Da Costa. | 22.2.2021'. |

(2) the following sentence is added after the table:

'* Article 6(1) shall not apply to entries identified with an asterisk.'.

**VENDIM**
**Nr. 373, datë 5.6.2024**

## PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 283, DATË 1.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E TIPAVE, RREGULLAVE, KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE PËR PRODHIMIN, RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE, NË TOKË BUJQËSORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, pikat 5/2 e 5/4, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës", të ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Nënparagrafi i gjashtë, i kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"- objektet për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe tregtimin e tyre.".

2. Pika 4, e nënkreut II.a, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Për qëllim të llogaritjes së vëllimit/sipërfaqes së ndërtimit në intensitetin e ndërtimit, përfshihet ngastra ose bllok ngastrash edhe kur ndahen nga rrugë, kanale apo kufij të tjerë natyralë, në pronësi apo përdorim. Leje ndërtimi për shtesat në ndërtimet ekzistuese dhe leje për objekte të reja, miratohen nëse nuk është shteruar intensiteti, sipas planit të përgjithshëm vendor ose planit të detajuar vendor ose intensiteti, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.".

3. Në nënkreun II.b bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën "a", të pikës 1, vëllimi "0.03 $m^3/m^2$" zëvendësohet me "3 $m^3/m^2$";

b) Shkronja "b", e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Të zhvillohen në një kat të vetëm dhe të respektohet lartësia maksimale 5.5 (pesë pikë pesë) metra, me përjashtim të oxhakëve, siloseve dhe strukturave që tejkalojnë këtë lartësi, për shkak të karakteristikave teknike.".

c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Për ndërtimin e stallave, që mbarështojnë mbi 50 (pesëdhjetë) njësi gjedhi mbi bazë, duhen të plotësohen këto kritere:

a) Të respektohen distancat minimale të mëposhtme:

i. 15 (pesëmbëdhjetë) metra nga kufijtë e pronës;

ii. 400 (katërqind) metra nga zonat e banuara;

iii. 50 (pesëdhjetë) metra nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.

b) Të zhvillohen në një kat të vetëm, me lartësi të ndryshme, në bazë të karakteristikave të veçanta teknike, dhe lartësi maksimale 6 (gjashtë) metra në ulluk dhe jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) metra në kulm;

c) Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej $4m^3/m^2$.".

Përjashtimisht, për stallat që ndërtohen me lartësi deri në 4 (katër) metra në ulluk, 6 (gjashtë) metra në kulm ose 4.5 (katër pikë pesë) metra, kur çatia është e drejtë, distanca nga prona kufitare është jo më pak se 7 (shtatë) metra. Në këto raste, vëllimi maksimal është $3m^3/m^2$.

ç) Lejet e ndërtimit për stallat dhe objektet ndihmëse miratohen vetëm nëse përmbushen kërkesat dhe kriteret e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe nuk ka shkarkime që krijojnë ndotje në ujë.".

ç) Në pikën 7, togfjalëshi "70%" zëvendësohet me "90%";

d) Në shkronjën "a", të pikës 10, vëllimi "1 $m^3/m^2$" zëvendësohet me "4 $m^3/m^2$";

dh) Shkronja "b", e pikës 10, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Të respektohen distancat minimale prej 5 (pesë) metrash nga kufijtë e pronës dhe distancat nga ndërtimet e tjera, pa cenuar funksionalitetin e tyre.".

e) Në shkronjën "a", të pikës 11, vëllimi "1 $m^3/m^2$" zëvendësohet me "4 $m^3/m^2$".

II. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/06/10 14:53:40 +02'00'
1365a7328a4b4c54943e6072c35b110b20240610
14533027031

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë*
*të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*